



## **SHQIPËRIA DHE KOSOVA**

### **Në kërkim të një të ardhmeje të përbashkët**

Dritan Sulçebe



# **SHQIPËRIA DHE KOSOVA**

## **Në kërkim të një të ardhmeje të përbashkët**

Dritan Sulçebe

**Aiis** Albanian Institute  
for International Studies

**FRIEDRICH  
EBERT**   
**STIFTUNG**

Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung  
Office Tirana  
Rr. Abdi Toptani  
Torre Drin, Kati i 3-të  
Kutia Postare 1418  
Tirane, Albania

Autor: Dritan Sulçebe

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert.

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

## Pasqyra e Lëndës

|                                                          |    |
|----------------------------------------------------------|----|
| Përmbledhje .....                                        | 5  |
| Hyrje .....                                              | 11 |
| 1. Konteksti Historik .....                              | 15 |
| 1.1 Vizioni Politik dhe procesi i integrimit në BE ..... | 18 |
| 2. Bashkëpunimi politik dhe diplomatik .....             | 25 |
| 3. Marrëdhëniet Ekonomike .....                          | 28 |
| 3.1 Bashkëpunimi tregtar&Problematikat .....             | 34 |
| 4. Kultura, Media dhe Arsimi .....                       | 40 |
| 4.1. Arsimi .....                                        | 45 |
| 5. Konkluzione .....                                     | 48 |
| 5.1 Rekomandime .....                                    | 50 |
| Referenca .....                                          | 53 |

## Përmbledhje

Ky studim është përgatitur në kuadër të projektit të përbashkët të Institutit Shqiptar për Studime Ndërkombëtare (AIIS) dhe fondacionit Friedrich Ebert Stiftung (FES): “Shqipëria dhe Kosova - Në kërkim të një të ardhmeje të përbashkët”. Kapitulli i parë është përqendruar tek dimensionin historik i marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Kosovës. Gjatë historisë së tyre, Kosova dhe Shqipëria kanë qenë të izoluara nga njëra tjetra për më shumë se katër dekada dhe kjo ka shkaktuar ndarje të thella si në aspektin ekonomik, politik ashtu dhe në atë shoqëror, të cilat ende vazhdojnë sot e kësaj dite. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, të dy vendet përjetuan një bashkim afat-shkurtër (1941-1944), i cili rezultoi shumë i suksesshëm në forcimin e lidhjeve të tyre ekonomike. Gjatë periudhës së regjimeve komuniste në Shqipëri dhe Jugosllavi, bashkëpunimi ishte i kufizuar vetëm në ndërveprime sporadike në rrafshin akademik dhe kulturor. Pas rënies së perdes së hekurt, izolimi i thellë vazhdoi të karakterizojë marrëdhëniet mes dy vendeve. Situata ndryshoi vetëm pas fillimit të luftës së Kosovës dhe vendosjes së administratës së UNMIK-ut në vitin 1999, përmes nënshkrimit të një sërë marrëveshjesh ekonomike dhe të tregtisë së lirë.

Pas pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, mund të flitet për herë të parë në histori për marrëdhënie ndërshtetërore midis dy shtetesh të pavarura dhe sovranë shqiptare. Në këtë kontekst, këto marrëdhënie janë duke përjetuar një dimension të ri ekonomik dhe politik i cili gjendet në zhvillim e sipër. Vizioni zyrtar politik i shprehur nga qeveritë dhe politikanët kryesorë në Shqipëri dhe Kosovë është i lidhur ngushtë me zhvillimet politike dhe gjeostrategjike globale dhe rajonale. Aktualisht, aktorët më të rëndësishme politike në të dy

vendet kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të respektuar kufijtë e njohur ndërkombëtarë.

Megjithëse, sipas sondazheve të ndryshme, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë në Kosovës dhe Shqipërisë është në favor të bashkimit, kjo çështje do të mbetet e kufizuar në retorikën nacionaliste të politikanëve për sa kohë të dy vendet do të jenë të varur në aspektin politik dhe atë ekonomik nga aktorët ndërkombëtarë, të cilët janë kundër çdo ndryshimi të kufijve në rajon. Nga ana tjetër, integrimi në Bashkimin Evropian vazhdon të jetë për të dy vendet perspektiva më e mirë për prosperitetin e ekonomive dhe shoqërive të tyre. Në këtë kuadër, qeveritë e të dy vendeve kanë përafruar politikat e tyre të brendshme dhe të jashtme sipas kornizës politike të BE-së. Ritmi i procesit të integritimit në BE, veçanërisht në rastin e Kosovës do të jetë vendimtar për konsolidimin e mëtejshëm të demokracive të të dy vendeve dhe në përmirësimin e marrëdhënieve midis tyre.

Bashkëpunimi politik dhe diplomatik ka qenë në përgjithësi i kufizuar në aktivitetet lobuese për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, Shqipëria ka qenë shumë aktive në këtë proces duke e ngritur këtë çështje në takimet e ndryshme të nivelit të lartë. Integrimi evropian është një tjetër fushë, ku të dy vendet janë duke bashkëpunuar. Shqipëria, e cila ka më shumë përvojë dhe ekspertizë në këtë aspekt, veçanërisht në lidhje me përkthimin dhe përafrimin e *acquis communautaire*, po ofron ndihmën e saj në institucionet e integritimit evropian të Kosovës. Janë shënuar edhe disa hapa përpara në drejtim të bashkëpunimit diplomatik, ndërsa dy vendet kanë rënë dakord për shërbime të përbashkëta konsullore në disa raste.

Marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve janë forcuar si rezultat i më shumë se tetë marrëveshjeve ekonomike të nënshkruara. Marrëveshja e partneritetit strategjik e nënshkruar në janar 2014 vendos theksin mbi nevojën për një treg të “integruar”. Të dyja

qeveritë kanë shprehur vullnetin e tyre për të forcuar lidhjet e tyre ekonomike. Megjithatë, barrierat ligjore dhe zbatimi i ngadaltë i marrëveshjeve të nënshkruara vazhdojnë të pengojnë marrëdhëniet ekonomike. Bashkëpunimi ekonomik mund të rritet vetëm me anë të politikave të përbashkëta të cilat do të nxisnin rritje të qëndrueshme ekonomike në të dy anët e kufirit. Në këtë prizëm, energjia ka një rëndësi të madhe në zgjerimin e mëtejshëm të vëllimit tregtar dhe ndërveprimin midis ekonomive të Kosovës dhe Shqipërisë. Projektet e përbashkëta në infrastrukturën energjetike do të kontribuonin në krijimin e një tregu të përbashkët të energjisë si një faktor shtytës në bashkëpunimin ekonomik midis të dy anëve të kufirit.

Siç vihet në dukje edhe nga statistikat zyrtare, Shqipëria dhe Kosova janë shndërruar në partnerë të rëndësishëm tregtarë. Megjithatë, vëllimi i përgjithshëm tregtar prej rreth 160 milionë Euro (2013) tregon se të dy vendet duhet të bëjnë më shumë përpjekje për të forcuar lidhjet e tyre ekonomike. Tregtia e lirë ka qenë e penguar për shkak të një sërë problemesh të natyrës teknike që kanë sfiduar seriozisht marrëdhëniet e mira mes dy vendeve. Autoritetet shqiptare kanë bllokuar produktet farmaceutike dhe miellin e grurit nga Kosova pasi këto produkte nuk ishin në përputhje me standardet ushqimore dhe farmaceutike shqiptare. Ndërkohë që tarifat e larta doganore ishin një tjetër arsye përse eksportet e patates nga Kosova shpeshherë janë bllokuar në kufirin me Shqipërinë. Nga ana tjetër, për shkak të të njëjtave arsye, autoritetet kosovare kanë imponuar kufizimet e tyre për importet nga Shqipëria, të tilla si: qumështi, çimento, etj. Çështja e problemeve në marrëdhëniet tregtare është diskutuar në shumë takime të autoriteteve të larta nga të dyja vendet dhe është shënuar progres sidomos në aspektin e përafrimit të standardeve në lidhje me ushqimin dhe produktet bujqësore. Megjithatë, dallimet në legjislacionin fiskal, tregtar dhe administrativ vazhdojnë të shkaktojnë pengesa të ndryshme në marrëdhëniet e dyanshme ekonomike.

Kultura është fusha ku bashkëpunimi është ende në fazat e tij fillestare. Marrëveshja për Partneritetin Strategjik midis Shqipërisë dhe Kosovës, në shtyllën e tij të katërt përcakton çështjet kryesore më të rëndësishme të bashkëpunimit kulturor dhe në këtë drejtim të dy vendet kanë rënë dakord për kalendarë të përbashkët kulturorë për vitet 2014 dhe 2015. Për më tepër, institucionet kulturore në Shqipëri dhe Kosovë kanë vendosur lidhje të konsoliduara duke kontribuar kështu në krijimin e një dimensionit të përbashkët kulturor Kosovë-Shqipëri. Në këtë kuadër, aktorët privatë kanë rezultuar të jetë shumë më të suksesshëm se institucionet shtetërore. Artistë, këngëtarë, shkrimtarë nga Shqipëria dhe Kosova kanë gjetur mënyra për të depërtuar në një treg të unifikuar kulturor midis të dy vendeve. Megjithatë, dy kulturat vijojnë të jenë të izoluara dhe të dy qeveritë përballen me sfidën e vështirë për të krijuar një hapësirë apo “Albanosferë” të përbashkët kulturore.

Në sektorin e medias, bashkëpunimi është arritur ndërmjet operatorëve publikë mediatikë (RTK-Kosovës dhe RTSH-Shqipëri) si dhe rregullatorëve audiovizualë të medias. Ashtu si në rastin e kulturës, komunikimi mes aktorëve më të rëndësishëm të mediave, sidomos për sa i përket medias së shkruar, është i pamjaftueshëm edhe pse bashkëpunimi ndërmjet stacioneve televizive private ka bërë disa hapa inkurajues përpara. Në përgjithësi, platformat e mediave janë të ndara dhe të përqendruara në tregjet e veçanta të Kosovës apo të Shqipërisë.

Një plan i përbashkët veprimi dhe hartimi i një strategjie për krijimin e një partneriteti të ri të medias Shqipëri-Kosovë mund të kontribuonte për ndryshimin e situatës.

Për sa i përket arsimit, Kosova dhe Shqipëria kanë qenë të përqendruar kryesisht në kurrikulat e përbashkëta dhe në standardizimin e teksteve shkollore. Gjatë takimit të fundit të përbashkët të përbashkët në mes të qeverive të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës,

të zhvilluar më 23 mars 2015, bashkëpunimi është zgjeruar më tej edhe në çështjet që i takojnë arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, mësimin e përbashkët të gjuhës shqipe në diasporë dhe trajnimin e përbashkët profesional të mësuesve. Sistemet arsimore në Shqipëri dhe Kosovë vuajnë nga probleme të ngjashme, por deri tani janë ndërmarrë pak përpjekje të përbashkëta për të trajtuar këto çështje. Konstituimi i një akademie shkencash të unifikuar do të lehtësonte krijimin e një sistemi të përbashkët arsimor dhe do të mundësonte një evoluim të përbashkët normativ të gjuhës shqipe në të dy anët e kufirit.

## Hyrje

Shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, shënoi fillimin e një ere të re në zhvillimet gjeopolitike në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kosovës, janë të rëndësishme për të përcaktuar orientimin dhe objektivat për të ardhmen këtyre dy vendeve si në kontekstin rajonal ashtu edhe në të evropian. Ka shumë diskutime në lidhje me marrëdhëniet midis dy shteteve. A duhet ata të bashkohen apo të vazhdojnë në rrugë të ndara si dy shtete të ndryshme të pavarura? Këto janë disa nga pyetjet më të përhapura të paraqitura në këtë kontekst. Në këtë studim, për arsye të shpjeguara më tej në detaje, është marrë i mirëqenë fakti që marrëdhëniet mes Kosovës dhe Shqipërisë duhet të konsiderohen si marrëdhënie midis dy shteteve të pavarura, të cilat përpiqen që të jenë të bashkuar nën ombrellën e BE-së. Sipas kësaj kornize teorike, studimi do të analizojë aspektet më të rëndësishme që përcaktojnë sot marrëdhëniet midis të dy vendeve, të tilla si: historia, politika, ekonomia, kultura, media dhe arsimi. Ky studim synon të hedhë dritë mbi sfidat më të rëndësishme me të cilat përballen marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë, zhvillimet më të rëndësishme si dhe të japë një paketë rekomandimesh për përmirësimin e bashkëpunimit në çështjet me ndikim më të madh duke dhënë një kontribut në konsolidimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis Kosovës dhe Shqipërisë.

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, por edhe në vitet e mëparshme, kur Kosova ishte ende një protektorat ndërkombëtar, dy vendet kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të vendosur marrëdhënie të qëndrueshme dhe bilaterale në shumë fusha. Megjithatë, deri më tani këto marrëdhënie kanë qenë në një masë të madhe zhgënjyese, pasi kanë dështuar të arrijnë standarde të



reja ekonomike dhe sociale që do të gjeneronin më shumë begati dhe lidhje më të forta kulturore. E kaluara, e shënuar nga një izolim i gjatë dhe mungesë të theksuar komunikimi mes të dy shoqërive, ende hedh hijen e saj negative në marrëdhëniet e reja në zhvillim midis Shqipërisë dhe Kosovës, duke i bërë ato disi të vështira. Edhe pse mbështetja e publikut në Shqipëri dhe Kosovë për marrëdhënie më të forta midis të dy vendeve është e madhe, shoqëritë, tregjet, ekonomitë dhe elitat politike të tyre janë zhvilluar në drejtime të ndryshme. Vlen të theksohet që bashkëpunimi ndërmjet të dy vendeve mund të fokusohet në një serë problematikash të përbashkëta. Shqipëria dhe Kosova janë duke përjetuar një krizë të thellë ekonomike dhe sociale që ndikon në të gjitha shtresat e shoqërive të tyre. Migrimi masiv, korrupsioni, de-industrializimi, strukturat e brishta shtetërore, infrastruktura e pazhvilluar dhe problemet mjedisore janë të gjitha çështje me të cilat janë duke u përballuar të dy shtetet.

<sup>1</sup> Për këtë arsye, bashkëpunimi nuk është vetëm një çështje e lidhur me politikën e BE-së në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar, por një interes vital me përfitime të mëdha si për Kosovën ashtu dhe për Shqipërinë. Zyrtarisht Kosova dhe Shqipëria kanë për qëllim të bëhen anëtarë të familjes evropiane. Partitë politike me më shumë ndikim në të dy vendet kanë lënë mënjatë aspiratën e bashkimit, për hir të së ardhmes në Bashkimin Evropian. Në nivelin politik, bashkëpunimi dhe lidhjet më të forta ekonomike midis të dy vendeve mbështeten nga të gjitha forcat politike. Politika e jashtme shqiptare ka qenë shumë aktive në promovimin e njohjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës dhe pranimin e shtetit të ri në organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare.

Fusha e cila më së shumti nxjerr në pah vështirësitë në marrëdhëniet mes dy vendeve është ekonomia. Kosova dhe Shqipëria janë vendet më të varfra në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Të ardhurat për

1. Oliver Jens Schmitt, “Die Albaner: Eine Geschichte zwischen Orient und Okzident”, Verlag C.H Beck. fq. 162

frymë të Shqipërisë janë rreth 4,659.3 dollarë, ndërsa ato të Kosovës 3,877.2 USD<sup>2</sup>. Ekonomitë e të dy vendeve janë të dominuara nga importi dhe sektori terciar. Siç është theksuar edhe nga Dr. Albert Rakipi në artikullin e tij “Roli qendror i Ekonomisë”: *Gjatë shekullit të kaluar, tregjet dhe ekonomitë e të dy vendeve kanë vepruar në mënyrë të izoluar, veçmas nga njëri-tjetri. Lidhjet tregtare të fillimit të shekullit të njëzetë, të ndërtuara përgjatë sundimit osman, u ndërprejnë për dekada të tëra. Kosova u bë pjesë e tregut të gjerë të Jugosllavisë ndërsa Shqipëria u izolua. Vitet e vështira nëntëdhjetë që shënuan rënien e regjimeve komuniste dhe shpërbërjen e Jugosllavisë sigurisht nuk ishin kohëra të mira për të bërë tregti. Së dyti, për shumë dekada dy ekonomitë kanë qenë kryesisht agrare duke siguruar vetëm mbijetesën e popullsisë. Ashtu si edhe në disa vende të tjera të Ballkanit niveli i industrializimit në Kosovë dhe Shqipëri mbetet i ulët duke penguar integrimin në sektorët fitimprurës të ekonomisë botërore. Së treti, tregjet dhe ekonomitë e vendeve të Ballkanit janë të orientuara në përgjithësi në drejtim të shteteve anëtare të BE-së, duke filluar me shtetet që gjenden në kufi si Italia dhe Greqia. Shkëmbimet tregtare midis vendeve ballkanike jo anëtare të BE-së janë ende larg përmbushjes së potencialit të tyre pasi janë ende jo-funksionale.*<sup>3</sup>

Dimensioni social dhe kulturor luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet mes dy vendeve. Shoqëritë e Kosovës dhe Shqipërisë ndajnë karakteristika të ndryshme për sa i përket rolit të fesë dhe familjes në shoqëri, ndërsa në të njëjtën kohë të dy shoqëritë pasqyrojnë tipare të përbashkëta në lidhje me zbatimin e ligjit, organizimit të komuniteteve, etj. Lidhjet midis të dy shoqërive vijnë të jenë të ulëta edhe pse përmirësimi i infrastrukturës rrugore përmes disa projekteve të mëdha infrastrukturorë si autostrada

2. Banka Botërore: <http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD>

3. Dr. Albert Rakipi, “Albania- Kosova, The Centrality of Economics”, Tirana Times, 2010.



Durrës-Kukës, kanë sjellë disa ndryshime pozitive. Bashkëpunimi midis instituteve apo organizatave të shoqërisë civile është i ulët dhe në shumicën e rasteve ai lëvrohet më së shumti në aspektin rajonal sesa në atë bilateral.

Ky studim do të adresojë pyetjet kryesore mbi dinamikën e lidhura me dimensionin politik, ekonomik dhe kulturor të marrëdhënieve të ndërsjella mes dy vendeve, përkatësisht: Si janë zhvilluar marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë në të kaluarën? Cili është vizioni politik në të dy vendet për të ardhmen e marrëdhënieve të tyre? Cilat janë perspektivat më të rëndësishme ekonomike? Cilat janë problemet kryesore në marrëdhëniet tregtare dhe si mund të zgjidhen ato? A janë kultura dhe media duke i afuar të dy vendet? Cila është gjendja e bashkëpunimit në fushën e arsimit? Metodatat kërkimore të aplikuara përbëhen nga këto komponentë: tryeza të rrumbullakëta, konferenca, monitorim i mediave, analizë e literaturës përkatëse dhe të dhënave të tjera dytësore.

## 1. Konteksti Historik

Konferenca e Londrës e zhvilluar më 1912-1913, përcaktoi kufijtë e tanishëm të Shqipërisë duke lënë jashtë mjaft territore të banuara nga shqiptarët, përfshirë këtu edhe Kosovën e sotme. Kjo pati pasoja të rënda sociale dhe ekonomike për shtetin e ri shqiptar, pasi rajonet e saj më të begata si dhe gjysma e popullsisë shqiptare u absorbuan nga shtetet fqinje në veri dhe jug të vendit. Çështja e humbjes së Kosovës dhe zonave të tjera të banuara nga shqiptarët ka pasur një ndikim të konsiderueshëm në politikën e brendshme dhe të jashtme shqiptare deri më 1925<sup>4</sup>, me marrjen e pushtetit nga ana e Ahmet Zogut, presidenti i parë (1925-1928) dhe më vonë (1928-1939), mbret i Shqipërisë. Gjatë sundimit të Zogut, Kosova pushoi së luajturi një rol të rëndësishëm në politikën e jashtme shqiptare për hir të konsolidimit të sovranitetit të Shqipërisë dhe marrëdhënieve të saj me Jugosllavinë fqinje<sup>5</sup>.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria dhe Kosova përjetuan një periudhë të shkurtër unifikimi (1941-1944). Edhe pse bashkimi ishte një produkt i dinamikës gjeopolitike e fuqive të boshtit në Evropë, kjo konsiderohet si e vetmja periudhë kur dy vendet u bashkuan nën një shtet të centralizuar shqiptar. Gjatë viteve 1941-1943 qeveria kukull shqiptare, hapi 173<sup>6</sup> shkolla fillore dhe të mesme në Kosovën e sotme me qëllim rritjen e nivelit të shkollimit dhe të ndërgjegjes kombëtare në mesin e popullatës lokale shqiptare. Në aspektin e përfitimeve ekonomike, vetëm gjatë 1942, njëzet mijë ton grurë

4. Elez Biberaj, “Çështja Kombëtare Shqiptare”, AHS 2014, fq.17.

5. Idem, fq.18

6. Bernd J. Fischer, “Albania at War: 1939-1945”, Hurst&Co, London, 1999, fq. 87

dhe tridhjetë mijë ton misër u eksportuan në Shqipëri<sup>7</sup> nga Kosova, duke siguruar kështu një tepricë të konsiderueshme të produkteve bujqësore dhe në të njëjtën kohë përmirësimin e perspektivës ekonomike të të dy vendeve.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria në fillim (1945-1948) vendosi marrëdhënie vëllazërore me Jugosllavinë titiste dhe marrëdhëniet me Kosovën u konsideruan si pjesë e bashkëpunimit në të gjitha fushat midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Gjatë kësaj kohe Shqipëria u afrua aq shumë me Jugosllavinë saqë bashkimi në mes dy vendeve dukej si i pashmangshëm. Megjithatë, gjatë ndarjes midis Titos dhe Stalinit udhëheqësi komunist i Shqipërisë, Enver Hoxha zgjodhi anën e sovjetikëve, duke shkaktuar kështu një krisje të marrëdhënieve me Jugosllavinë, e cila zgjati deri në shpërbërjen e shtetit një- partiak në Shqipëri në vitin 1990. Gjatë viteve 1948-1990 Kosova u përdor kryesisht në kuadër të retorikës nacionaliste të Hoxhës<sup>8</sup>. Megjithatë në vitin 1971, me përmirësimin e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, Kosova dhe Shqipëria vendosën kontakte të drejtpërdrejta. Universiteti i Prishtinës nënshkroi disa marrëveshje me Universitetin e Tiranës, me qëllim të krijimit të lidhjeve që do të mundësonin shkëmbimin e stafit pedagogjik e të teksteve mësimore, bashkëpunimin në lidhje me projektet e përbashkëta në arkeologji ,etj<sup>9</sup>. Lidhjet midis Shqipërisë dhe Kosovës gjatë kësaj periudhe kontribuan edhe në forcimin e ndërgjegjes kombëtare në mesin e shqiptarëve të Kosovës, e cila rezultoi të jetë një faktor i rëndësishëm për shpërthimin e protestave të studentëve të Kosovës të vitit 1981, të cilat kishin si qëllim zgjerimin e autonomisë e krahinës në kuadër të Federatës Jugosllave.

Pas vendosjes së pluralizmit politik në vitin 1991, Shqipëria ishte i

7. Idem

8. Oliver Jens Schmitt, “Die Albaner: Eine Geschichte zwischen Orient und Okzident”, Verlag C.H Beck, fq. 162

9. Elez Biberaj, “Çështja Kombëtare Shqiptare”, AIIS 2014, fq. 31.

vetmi shtet në botë i cili njohu “Republikën e Kosovës” (në vitin 1992) duke luajtur njëkohësisht një rol aktiv në promovimin ndërkombëtar të çështjes së Kosovës. Qeveritë e drejtuara nga Partia Demokratike gjatë viteve 1992-1997, ndërsa mbështesnin aspiratat e Kosovës për vetëvendosje, u përpoqën në të njëjtën kohë të kontribuonin në stabilitetin e rajonit, duke mos përkrahur dhunën dhe ndryshimet e kufijve. Një politikë e ngjashme u ndoq edhe nga qeveritë socialiste (1997-2005), edhe pse kryeministri Fatos Nano mbështeti më tej integritetin territorial të Jugosllavisë duke deklaruar në vitin 1998 se Kosova ishte një çështje e brendshme e Jugosllavisë.<sup>10</sup>

Megjithatë, me përshkallëzimin e luftës së Kosovës, gjatë 1998-1999, politika e jashtme e Shqipërisë filloi të ndryshojë në favor të UÇK-së dhe luftës e saj për pavarësi<sup>11</sup>. Gjatë vitit 1998 dhe gjatë fushatës ushtarake të NATO-s në Jugosllavi (mars-qershor 1999), Shqipëria lejoi në territorin e saj, aktivitetin e pakufizuar të UÇK-së dhe vuri dispozicion të NATO-s të gjithë të infrastrukturën e saj ushtarake dhe civile. Është e rëndësishme të theksohet se gjatë luftës në Kosovë nga 848.100 refugjatë<sup>12</sup>, të cilët u larguan nga vendi, 444.600 shkuan në Shqipëri dhe qëndruan atje deri në përfundimin e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në qershor të vitit 1999. Shqipëria mbajti barrën kryesore përgjatë krizës humanitare të Kosovës dhe në të njëjtën kohë dha një kontribut të rëndësishëm në lirinë e kësaj të fundit. Lufta e Kosovës shënoi fillimin e një epoke të re, në të cilën të dyja vendet nisën t’i afrohen njëri-tjetrit pas pothuajse një gjysmë shekulli izolimi të plotë. Pas luftës, marrëdhëniet midis dy vendeve sinjalizuan arritje të rëndësishme në çdo fushë. Megjithatë, marrëdhëniet midis të dyja vendeve përjetuan një dimension të ri vetëm pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në 2008, duke u zhvilluar në marrëdhënie ndër-shtetërore. Si dy shtete të pavarura

10. Elez Biberaj, “Çështja Kombëtare Shqiptare”, AIIS-2014, fq. 68

11. Idem, pg. 91

12. Tim Judah, “Kosovo: War and Revenge”, Yale Nota Bene-2002, fq.250

dhe sovrane, Kosova dhe Shqipëria kanë tashmë mundësinë për të përparuar më tej bashkëpunimin e tyre në shumë fusha, duke sjellë përfitime ekonomike dhe kulturore për popujt e të dy vendeve.

### 1.1 Vizioni Politik dhe Procesi i Integritimit në BE

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, ne mund të flasim për herë të parë në histori për dy shtete të pavarura shqiptare në rajon. Duke marrë parasysh këtë realitet të ri ka një sërë pyetjesh që duhet të marrin përgjigje.

A janë dy shtete të ndara shqiptare një zgjidhje e arsyeshme, e cila do të zgjasë në kohë? A pasqyron ky realitet i ri vullnetin politik të shqiptarëve që jetojnë në të dyja anët e kufirit? Dhe pyetja e fundit por jo më pak e rëndësishmja: Cili është vizioni dominues politik në Kosovë dhe Shqipëri në marrëdhëniet mes dy vendeve?

Duke filluar me pyetjen e fundit, Shqipëria dhe Kosova, si dy nga vendet më të varfra në Evropë, me probleme të mëdha në lidhje me sundimin e ligjit, janë dy shtete ende të varur nga asistenca e huaj si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë dhe politik. Në rastin e Kosovës, ndërhyrja amerikane gjatë luftën së Kosovës dhe më vonë, në shpalljen e pavarësisë në vitin 2008, ishte e dobishme si për mbijetesën e vendit ashtu edhe për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për fuqitë evropiane perëndimore, të cilat përmes mbështetjes së tyre politike dhe ekonomike kanë luajtur një rol të rëndësishëm në konsolidimin e strukturave shtetërore të Kosovës dhe stabilitetin politik të vendit. Mbështetja e huaj ekonomike dhe politike ka qenë gjithashtu një faktor përcaktues në rrugën e gjatë të Shqipërisë drejt konsolidimit të demokracisë dhe integritit të saj në strukturat euro-atlantike. Shqipëria u bë anëtare e plotë e NATO-s në prill të 2009-ës dhe në qershor të vitin 2014 iu dha statusi i kandidatit të BE-së. Këto

arritje të rëndësishme nuk mund të realizoheshin dot pa ndihmën e aktorëve ndërkombëtarë si SHBA, NATO apo BE. Të dyja vendet ia detyrojnë arritjet më të mëdha ekonomike dhe atyre në rrafshin politik aktorëve ndërkombëtarë, e për këtë arsye politika e tyre e jashtme me shumë gjasë do të influencohet nga këta të fundit edhe në të ardhmen.

Në këtë drejtim, BE-ja luan një rol themelor pasi të dyja vendet aspirojnë të integrohen në BE. Gjatë 2007-2012, Kosova ka marrë ndihmë financiare përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit me vlerë prej 565,1 milionë euro<sup>13</sup>. Nga ana tjetër, Shqipëria ka përfituar nga asistenca e IPA (2007-2013) rreth 515.000.000 euro<sup>14</sup>. Për më tepër, procesi i anëtarësimit në BE kërkon nga të dyja vendet që të përmbushin kriteret e Kopenhagenit, të cilat përcaktojnë tri komponentë kryesorë: politikë (stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut si dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve), ekonomikë (ekzistenca e një ekonomie të tregut funksionale dhe kapacitetet për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcave të tregut brenda dhe forcave të tregut brenda unionit) dhe pranimin e *acquis* komunitare (aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit duke përfshirë respektimin e qëllimeve të bashkimit politik, ekonomik dhe monetar)<sup>15</sup>. Në këtë kontekst, hapësira e të dyja vendeve për të manovruar jashtë kuadrit të përgjithshëm politik dhe ekonomik të BE-së është e vogël, pasi politikat e jashtme dhe të brendshme të Kosovës dhe Shqipërisë janë të lidhura ngushtë me ato të Bashkimit Evropian. Deri më tani, BE-ja ka ndjekur axhendën e saj rajonale, sipas së cilës të gjithë vendet e rajonit duhet të angazhohen në

13. Zyra e BE në Kosovë, Bashkëpunimi teknik dhe financiar [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu\\_kosovo/tech\\_financial\\_cooperation/index\\_en.htm](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu_kosovo/tech_financial_cooperation/index_en.htm)

14. Idem

15. Faqja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Përmbledhje e legjislacionit të BE, Kriteret e Anëtarësimit: [http://europa.eu/legislation\\_summaries/glossary/accession\\_criteria\\_copenhagen\\_en.htm](http://europa.eu/legislation_summaries/glossary/accession_criteria_copenhagen_en.htm)

bashkëpunimin ndërkuftar dhe natyrisht në respektimin e kufijve të njëri tjetrit. Në rastin e Kosovës, BE-ja ka shtyrë vendin në një seri bisedimesh lidhur me çështjet me interes të përbashkët me Beogradin, të cilat kanë rezultuar në marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013 midis Kosovës dhe Serbisë. Edhe pse Serbia ende nuk e njeh zyrtarisht pavarësinë e Kosovës, ajo është e angazhuar përmes marrëveshjes së Brukselit për të njohur autoritetin administrativ të Prishtinës brenda kufijve të njohur ndërkombëtarisht të Kosovës. Nëpërmjet marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013, BE ka rritur të mbyllë çdo shteg që mund të çonte në një rishikim të kufijve në Ballkanin Perëndimor. Në këtë prizëm, partitë më të mëdha politike në Shqipëri dhe Kosovë së bashku me udhëheqësit e tyre përkatës, të vetëdijshëm për potencialin ekonomik dhe politik të vendeve të tyre, janë tërësisht të angazhuar në ruajtjen e kufijve aktualë dhe në zbatimin e plotë të të gjitha rekomandimeve të BE-së në lidhje me politikën jashtme. Kjo shpjegon edhe arsyen përse forcat më të rëndësishme politike në të dy anët e kufirit kanë pranuar qëndrime të tilla si: “ Bashkimi nën ombrellën e BE-së”, “ Një komb dy shtete”, “Bashkimi midis Shqipërisë dhe Kosovës do të ndodhë një mënyrë evropiane”.<sup>16</sup>

Nga ana tjetër çështja e vullnetit politik të shqiptarëve në Kosovë dhe Shqipëri mbi bashkimin e dy vendeve është e lidhur ngushtë me zhvillimet ekonomike dhe politike. Sondazhet e ndryshme të kryera në Shqipëri dhe Kosovë, tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë në të dy vendet është pro bashkimit. Sipas gjetjeve të sondazhit Gallup Balkan Monitor 2010, 63% e popullsisë në Shqipëri dhe 81% e popullsisë në Kosovë, mbështet idenë e një Shqipërie të madhe.<sup>17</sup>

16. Bujar Nishani: Bashkimi Shqiperi Kosove do te ndodhe, Gazeta Tema, 13 Janar 2015: <http://www.gazetatema.net/web/2015/01/13/bujar-nishani-bashkimi-shqiperi-kosove-do-te-ndodhe/>

17. Sondazhi Gallup Balkan, kryer mw Qershor-Korrik 2010: [http://www.esiweb.org/enlargement/wp-content/uploads/2009/02/2010\\_Summary\\_of\\_Findings.pdf](http://www.esiweb.org/enlargement/wp-content/uploads/2009/02/2010_Summary_of_Findings.pdf)

Nga ana tjetër, rezultatet e hulumtimit të kryer nga Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare në vitin 2013, tregojnë se 49% e shqiptarëve në Shqipëri e konsiderojnë bashkimin me Kosovën si një gjë pozitive (29% as pozitiv dhe as negativ, 12% nuk e di, 10% negativ)<sup>18</sup>. Ky studim më tej tregon se 63% e qytetarëve shqiptarë mendojnë se qeveria shqiptare duhet t’i kushtojë më shumë vëmendje forcimit të bashkëpunimit me Kosovën.<sup>19</sup>

Për sa më sipër arrijmë përfundimin që çështja e bashkimit vijon të ketë një ndikim të konsiderueshëm në të dy vendet, edhe pse në një shkallë më të madhe në Kosovë sesa në Shqipëri. Në nivelin politik, çështja e bashkimit për sa i përket Kosovës është artikuluar nga lëvizja politike “Vetëvendosje” e cila në zgjedhjet e kaluara parlamentare të 2014, mori 13,59%<sup>20</sup> të votave. Ndërsa lëvizja politike në Shqipëri, e cila mbështet haptazi bashkimin mes Shqipërisë dhe Kosovës është partia Aleanca Kuq e Zi (vetëm 0.61% të votave në zgjedhjet parlamentare të 2013)<sup>21</sup>. Siç mund të shihet, në nivelin politik përkrahësit e çështjes bashkimit janë ende një pakicë në të dyja vendet. Megjithatë, siç tregohet edhe nga anketat e ndryshme, kjo çështje ka shumë potencial për t’u shfrytëzuar më tej politikisht në të ardhmen. Në këtë kuadër, dinamikat politike dhe ekonomike të integritit për në BE, do të luajnë një rol të rëndësishëm në të dy vendet. Nëse Shqipëria dhe Kosova do të dështojnë në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në BE duke vonuar kështu procesin e integritit, atëherë tendencat nacionaliste do të fitonin terren dhe

18. The state of Albanian Democracy at the eve of 2013 General Elections, AIIS, Tirana 2013, fq.41

19. Idem, fq.40

20. Republika e Kosovës, Komisioni qendror i Zgjedhjeve, Zgjedhjet per Kuvendin e Kosoves 2014: [http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Rezu%20-%20Nivel%20Vendi%20-%20sipas%20subjekteve\\_peufawqvmc.pdf](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Rezu%20-%20Nivel%20Vendi%20-%20sipas%20subjekteve_peufawqvmc.pdf)

21. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet: [http://www2.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-per-kuvend/2013/zgjedhje\\_2013\\_web/lidhja1.pdf](http://www2.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-per-kuvend/2013/zgjedhje_2013_web/lidhja1.pdf)

numri i mbështetësve të bashkimit Kosovë-Shqipëri do të rritej. Këtu vlen të trajtohet edhe pyetja e parë (A Janë dy shtete të ndara shqiptare një zgjidhje e arsyeshme, e cila do të zgjasë në kohë?) e ngritur në fillim të këtij kapitulli. Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, Kosova i është nënshtruar një seri bisedimesh të sponsorizuara nga BE me Serbinë, me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve me fqinjën e saj verior. Bisedimet vazhdojnë sot e kësaj dite dhe në shumë raste ato kanë qenë të dhimbshme për palën kosovare, pasi Kosova është detyruar të pranojë një seri e koncesionesh që potencialisht mund të dëmtojnë shumë aspekte të sovranitetit të saj. Për shembull, në bazë të marrëveshjes Kosovë-Serbi të nënshkruar në mars 2012, e cila përcakton emërtimin e Kosovës në dokumentet dhe takimet ndërkombëtare, shteti do të referohet si Kosova\* me asteriskun që indikon se: “Ky përcaktim nuk paragjykon qëndrimet e ndryshme mbi statusin, dhe është në përputhje me rezolutën 1244 të OKB dhe opinionin e GjND mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.”<sup>22</sup> Në këtë mënyrë, nga viti 2012 e tutje Kosova në arenën ndërkombëtare ka hequr dorë nga përcaktimi i saj kushtetues si “Republika e Kosovës”. Është e vërtetë se kjo marrëveshje ka lehtësuar përfaqësimin e Kosovës në organet e ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare dhe se ajo i ka dhënë një shtysë përpara procesit të integritetit të vendit në BE. Sidoqoftë, asterisku dhe fusnota janë tregues të fortë se pavarësia e Kosovës është ende e brishtë dhe se ajo nuk është një proces i pakthyeshëm. Për më tepër, marrëveshja e Brukselit e vitit 2013 legjitimon njohjen e bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë dhe de facto përcakton autonominë rajonale për zonat me shumicë serbe në veri të Kosovës. Edhe pse marrëveshja është një hap i rëndësishëm drejt normalizimit të marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë, ajo përbën në të njëjtën kohë një pengesë në përparimet e Kosovës për shtrirjen e sovranitetit në

22. Delegacioni i BE në Kombet e Bashkuara, Be lehtwsoi dialogun midis Kosovës dhe Serbisë: Agreement on Regional Cooperation and IBM technical protocol: [http://eu-un.europa.eu/articles/en/article\\_11884\\_en.htm](http://eu-un.europa.eu/articles/en/article_11884_en.htm)

të gjithë territorin e saj. Për më tepër, pavarësia e Kosovës ende nuk është njohur nga pesë anëtarë të BE-së (Spanja, Sllovakia, Greqia, Qipro dhe Rumania) dhe kjo përbën gjithashtu një pengesë të madhe në hapat e ardhshëm të procesit të integritetit të vendit në BE, përkatësisht nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe marrëveshjen e liberalizimit të vizave me BE-në.

Dështimi i politikës së jashtme të Bashkimit Evropian për të trajtuar Kosovën përmes një zëri të vetëm, ka të ngjarë të ngadalësojë përparimet integruuese të vendit, duke kërcënuar aspiratat e tij evropiane. Për sa më sipër, e ardhmja e Kosovës duket mjaft e pasigurt dhe eksodi i fundit, i cili po largon dhjetëra mijëra kosovarë larg shtëpive të tyre për të gjetur një të ardhme më të mirë në Evropën perëndimore tregon mungesën e shpresës që qytetarët e Kosovës kanë për të ardhmen e vendit. Pasiguria për të ardhmen e Kosovës do të shkaktonte ngritjen e shumë pyetjeve mbi çështjen nëse shpallja e pavarësisë dhe njohja e saj nga komuniteti ndërkombëtar ishte diçka e drejtë dhe gjithashtu mund të shkaktonte fillimin e bisedimeve të reja me Serbinë dhe aktorët e tjerë ndërkombëtarë që do të kishin si objekt ri-negocimin e statusit ndërkombëtar të vendit. Në këtë drejtim, çështja e ndarjes së Kosovës ose bashkimi i saj me Shqipërinë, si pjesë e zgjidhjes së çështjes shqiptare do të shtrohej në mënyrë të pashmangshme në tryezë. Nga ana tjetër, një proces i suksesshëm dhe i shpejtë i integritetit evropian për Shqipërinë dhe Kosovën, i ndjekur nga prosperiteti ekonomik dhe standarde të larta demokratike në të dyja vendet, do të krijonte kushtet e përshtatshme për qëndrueshmërinë e dy shteteve të ndryshme shqiptare në një Ballkan Perëndimor të integruar tërësisht në BE.



## 2. Bashkëpunimi Politik dhe Diplomatik

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, diplomacia shqiptare ka qenë shumë aktive në sigurimin e njohjeve ndërkombëtare për shtetin e ri. Diplomatët dhe zyrtarët e lartë të Shqipërisë gjatë vizitave të tyre zyrtare në pjesë të ndryshme të botës në shumë raste kanë lobuar për njohjen ndërkombëtare të Kosovës.<sup>23 24</sup>

Në një takim të zhvilluar në nëntor 2012 midis ministrit të jashtëm të Kosovës Enver Hoxhaj dhe homologut të tij shqiptar Edmond Panariti, ky i fundit shprehu përkushtimin e qeverisë shqiptare për “lobimin e fuqishëm të Shqipërisë për njohjen ndërkombëtare të Kosovës”.<sup>25</sup>

Aktivitetet lobuese janë kryer nga zyrtarët shqiptarë në takime të ndryshme ndërkombëtare, si për shembull në rastin e miratimit nga ana e Organizatës së Konferencës Islamike në vitin 2009 (Samitin e 40-të Këshillit të Ministrave të Jashtëm të OKI) të rezolutës së propozuar nga Shqipëria në dhjetor 2013 në bazë të së cilës vendeve anëtare të OKI-t iu bë thirrje për të njohur pavarësinë e Kosovës.<sup>26</sup>

Njëri prej prioritetëve kryesorë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë është bashkëpunimi strategjik me Kosovën, sipas të

23. Shih- Telegrafi.com, Berisha, lobim per njohjen e Kosoves: <http://www.telegrafi.com/lajme/berisha-lobim-per-njohjen-e-kosoves-78-5759.html>

24. Shih- Gazeta Tema, Rama në Rumani kërkon njohjen e Kosovës <http://www.gazetatema.net/web/2015/02/27/rame-ne-rumani-kerkon-njohjen-e-kosoves/>

25. Kosova Online, Shqipëria lobim të fuqishëm për njohjen e Kosovës: <http://kosovaonline.info/?page=1,3,20505>

26. Kosova Press, “OIC adopts resolution on Kosovo”, <http://www.kosovapress.com/en/politics/oic-adopts-resolution-on-kosovo-7307/>

*cilit: “Bashkëpunimi strategjik me Kosovën do të jetë në funksion të rritjes ekonomike dhe cilësisë së jetës dhe përshpejtimit të procesit të integrimit euro-atlantik. Prania e dy shteteve, Shqipërisë dhe Kosovës, përbën një kapacitet qeverisës dhe administrativ shumë të madh për të ndërtuar një të ardhme të përbashkët euro-atlantik. Ne do të vijojmë ndërmarrjen e hapave që ndihmojnë procesin e njohjeve të mëtejshme të Kosovës në arenën ndërkombëtare.”<sup>27</sup>*

Më tej, të dy vendet kanë nënshkruar një marrëveshje (nënshkruar në Prishtinë më 13 janarit 2012), për të bashkuar shërbimet konsullore në disa prej përfaqësive të tyre në botë. Deri më tani kjo marrëveshje është zbatuar përmes krijimit të një konsullate të përbashkët shqiptaro-kosovare më shtator 2014 në Milano, Itali. Një tjetër konsullatë e përbashkët pritet të hapet në të ardhmen e afërt në Kanbera, Australi.<sup>28</sup>

Në lidhje me integrimin në BE, Shqipëria ka shprehur angazhimin e saj për të ndihmuar Kosovën përmes ekspertizës së saj përkatëse. Kohet e fundit, Ministria e Integrimit European të Shqipërisë ka ndarë materialin e përkthyer të *Acquis communautaire* me ministrinë homologe nga Kosova dhe është duke bashkëpunuar më tej me këtë të fundit në kuadër të Komisionit Teknik për përafrimin dhe përkthimin e legjislacionit të BE-së.<sup>29</sup>

Politika e Shqipërisë ndaj Kosovës duke mos parasysh këtu retorikën patriotike, ka qenë në përgjithësi në të njëjtën linjë me iniciativat e BE-së dhe të politikës amerikane dhe shtetet e Evropës

27. Ministria e Punëve të Jashtme, Misioni, Prioritetet, <http://www.punetegashtme.gov.al/al/misioni/perparesite/prioritetet>

28. Ministria e Punëve të Jashtme, “Albania and kosovo inaugurate first joint consulate in Milan”, <http://www.punetegashtme.gov.al/en/press-office/news/albania-and-kosovo-inaugurate-first-joint-consulate-in-milan>

29. Gazeta Shqip, Ministrja e Integrimit Evropian, Klajda Gjoshë vizitë zyrtare në Kosovë. <http://gazeta-shqip.com/lajme/2014/03/25/ministrja-e-integrimit-evropian-klajda-gjoshë-vizite-zyrtare-ne-kosove/>

Perëndimore kundrejt Kosovës. Kështu, Shqipëria ka qenë një mbështetëse e bisedimeve Prishtinë-Beograd dhe të marrëveshjes së Brukselit, e cila është konsideruar nga Ministria e Punëve të Jashtme si: *“Marrëveshja historike e 19 prillit, pritet të normalizojë marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë, duke nisur një epokë të re mes tyre, me një impakt në mbarë rajonin. Ne presim që kjo marrëveshje t’i japë një impuls të ri njohjeve të reja të Kosovës dhe anëtarësimit të saj në forumet rajonale, BE dhe OKB.”*<sup>30</sup>

Gjatë vizitës së tij të fundit në Beograd (nëntor 2014), kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama u shpreh se: “Kosova e pavarur është një realitet i pamohueshëm rajonal dhe evropian, dhe si i tillë ai duhet të respektohet”<sup>31</sup>, duke përforcuar kështu angazhimin e vazhdueshëm të qeverisë shqiptare për të promovuar pavarësinë e Kosovës, madje edhe përballë kundërshtarëve të saj më të ashpër, siç është rasti i Serbisë.

Marrëveshja e Partneritetit Strategjik mes Shqipërisë dhe Kosovës të nënshkruar më 11 janar në Prizren, Kosovë, shënon një moment të rëndësishëm në marrëdhëniet mes dy vendeve. Në kapitullin për siguri dhe politikë të jashtme dy qeveritë shprehin vullnetin e tyre të përbashkët për bashkëpunim në thellimin lidhjen e tyre me anëtarët e SHBA dhe të BE-së. Gjithashtu Shqipëria është e përkushtuar përmes kësaj marrëveshje të vazhdojë mbështetjen e saj mbi njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës dhe anëtarësimin e saj në BE, Këshillin e Evropës dhe në NATO.<sup>32</sup>

Ashtu siç është theksuar nga kreu i Komisionit Parlamentar të

30. Ministry of Foreign Affairs, Albania in the Region: <http://www.punetejashtme.gov.al/en/mission/albania-in-the-region>

31. BBC News, Serbia-Albania row over Kosovo marks historic Rama visit, <http://www.bbc.com/news/world-europe-29985048>

32. Shqiptarja.com, Deklarata per Bashkepunimin strategjik Shqiperi-Kosove: <http://www.scribd.com/doc/199103574/Deklarata-per-bashkepunim-dhe-partneritet-strategjik-Shqiperi-Kosove>

Kosovës për Politikë të Jashtme, Enver Hoxhaj<sup>33</sup>: “Marrëveshja e Partneritetit Strategjik vendos marrëdhëniet mes dy vendeve në një kuadër të ri ligjor dhe institucional. Gjithashtu ai është edhe skenari më i qëndrueshëm në zhvillimin e marrëdhënieve midis dy vendeve në të ardhmen.”

Megjithatë, ka patur raste kur partneriteti strategjik është përdorur si një mjet propagande për të gjetur mbështetje ndër nacionalistët në të dyja vendet. Për shembull, mbledhja e dytë e përbashkët midis dy qeverive zhvilluar në Tiranë (22 mars 2015) solli pak substancë në zgjerimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe ajo u përdor në masë të madhe kryesisht nga kryeministri shqiptar të Edi Rama për të promovuar vizionin e tij të “nacionalizmit evropian” shqiptar të shprehur në mënyrë të qartë përmes motos së takimit: “një tokë, një komb, një ëndërr”<sup>34</sup> dhe nga flamujt e Shqipërisë dhe të BE-së që dekoronin tryezën e rrumbullakët, ku ishin mbledhur të dy qeveritë.

33. Konferenca: “Shqipëria dhe Kosova në kërkim të një të ardhmeje të përbashkët”, AIIS, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë 28.04.2015.

34. Gazeta Panorama, “Mbledhja e dy qeverive, Rama: Te hiqen vizat per Kosoven, turp per Europen”: <http://www.panorama.com.al/mbledhja-e-perbashket-e-qeverive-shqiperi-kosove-neser-ne-1100-ne-pallatin-e-kongreseve-ja-axhenda/>



### 3. Marrëdhëniet Ekonomike

Për sa i përket ekonomisë, të dy vendet kanë nënshkruar një sërë marrëveshesh ekonomike me qëllim të konsolidimit të mëtejshëm të lidhjeve të tyre ekonomike dhe krijimin e kushteve të nevojshme për krijimin e një tregu të përbashkët në të ardhmen. Në kontekstin rajonal, Kosova ka nënshkruar 30 marrëveshje ekonomike dhe memorandume mirëkuptimi me vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë drejtim Shqipëria zë peshën më të madhe me tetë marrëveshje të nënshkruara.<sup>35</sup>

Këtu janë disa nga marrëveshjet më të rëndësishme të bashkëpunimit ekonomik të nënshkruara nga të dyja vendet:

- Memorandumi i Mirëkuptimit midis Zyrës Shqiptare të Investimeve dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara të Administratës së Përkohshme në Kosovë (UNMIK), nënshkruar në Tiranë më 2002/09/09.
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë ndërmjet Shqipërisë dhe UNMIK-ut, 07.07.2003.
- Marrëveshja ndërmjet Shqipërisë dhe UNMIK-ut për promovimin dhe mbrojtjen reciproke të investimeve, nënshkruar më 2004/02/19, hyrë në fuqi më 7 shkurt 2005.
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe UNMIK-ut për shmangien e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin e evazionit

35. KIPRED, Kosovar Institute for Policy Research and Development, “Kosova ne Kontekst Rajonal: Marrëdhëniet Ekonomike dhe Tregtare”, Pg.9.

fiskal nënshkruar më 28.09.2004, e cila ka hyrë në fuqi më 31.03.2005.

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë në çështjet doganore, nënshkruar më 10.06.2009, hyrë në fuqi më 01.03.2010
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për Transportin Ndërkombëtar Rrugor për udhëtarët dhe mallrat, nënshkruar më 22.07.2011, hyrë në fuqi më 21.11.2011.<sup>36</sup>
- Marrëveshja për Partneritetin Strategjik midis Shqipërisë dhe Kosovës, nënshkruar më 11.01.2014.
- Marrëveshja Kuadër ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës për bashkëpunimin dhe Promovimin me qëllim lehtësimin e tregtisë nënshkruar në 01.11.2014.

Shtylla e tretë e marrëveshjes së partneritetit strategjik midis Shqipërisë dhe Kosovës përcakton se: “*Vullneti i të dy vendeve për të krijuar kushte të favorshme për biznesin për një treg të integruar, të cilat do të mundësojnë zhvillimin e ekonomive komplementare me anë të një strategjie afatgjatë. Të dyja palët janë të përkushtuar që të punojnë intensivisht me aktorët përkatës për të mundësuar TAP (tubacioni Trans-Adriatik) në Kosovë dhe zhvillimi i një tregu të brendshëm dhe rajonal i gazit të lëngshëm. Palët janë angazhuar për ndërtimin e një rrjeti të tensionit të lartë ndërkufitar të transmetimit. Të dyja qeveritë do të angazhohen në bashkëpunim të ngushtë në transport, turizëm dhe në kuadër të një marrëveshje të përbashkët për menaxhimin e burimeve ujore*”<sup>37</sup>. Nga ana tjetër, Marrëveshja

36. Ministria e Punëve të Jashtme, Marrëveshjet dypalëshe: [http://www.punetegashtme.gov.al/files/userfiles/Marreveshjet\\_Dypaleshe\\_me\\_te\\_gjitha\\_vendet.pdf](http://www.punetegashtme.gov.al/files/userfiles/Marreveshjet_Dypaleshe_me_te_gjitha_vendet.pdf)

37. Shqiptarja.com, Deklarata per Bashkepunimin strategjik Shqiperi-Kosove:

Kuadër ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës për nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë, detajohet më tej duke përcaktuar më shumë fusha të cilat mund të kontribuojnë në lehtësimin dhe nxitjen e tregtisë së lirë midis dy vendeve të tilla si:

- Përafrimin gradual i legjislacionit dhe standardeve në fushën e sigurisë ushqimore.
- Përafrimi i legjislacionit të importit masat mbrojtëse dhe të anti-dumping
- Përafrimi i legjislacionit në kuadër të pronësisë intelektuale
- Përsheptimi i masave të ndërmarra nga organizmat akreditues të dy vendeve për nënshkrimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe me Organizatën Europiane të Akreditimit fillimisht në laboratorët e testimit, dhe më tej në të gjitha fushat e tjera;
- Shkëmbimi i informacionit mes zyrave doganore
- Përafrimi dhe thjeshtimi i procedurave të tranzitit

Më tej, neni 6 i marrëveshjes përcakton se të dyja palët do të krijojnë grupe të përbashkëta pune për eliminimin gradual të barrierave jo-tarifore të tregtisë në fusha të ndryshme si:

- Barrierat teknike në tregti
- Masat sanitare, fitosanitare dhe veterinare
- Barrierat administrative, veçanërisht ato në lidhje me zyrat doganore.<sup>38</sup>

<http://www.scribd.com/doc/199103574/Deklarata-per-bashkepunim-dhe-partneritet-strategjik-Shqiperi-Kosove>

38. <http://www.ligjet.org/>, “Për miratimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet

Edhe pse marrëveshjet e lartpërmendura nuk kanë arritur t’u japin fund të gjitha mosmarrëveshjeve tregtare midis dy vendeve, ato përbëjnë një moment të rëndësishëm për konsolidimin e mëtejshëm të lidhjeve komerciale përgjatë të dy anëve të kufirit. Vlen të theksohet se këto marrëveshje ekonomike duhet të zbatohen plotësisht, në mënyrë që të eliminohen të gjitha mosmarrëveshjet tregtare dhe për këtë të dyja vendet kanë shumë punë përpara. Marrëveshjet bilaterale të nënshkruara përbëjnë një hap të madh përpara në marrëdhëniet midis dy vendeve. Megjithatë, marrëdhëniet tregtare dhe ekonomike rrezikohen nga pengesat ligjore, të ofruara nga të dyja vendet. Në këtë kuadër, mund të themi që Shqipëria dhe Kosova duhet të marrin hapa të mëtejshëm në drejtim të përafrimit dhe harmonizimit të legjislacionit të tyre tregtar, të punës dhe atë bankar. Në shkurt 2015 “Korridori i përbashkët Transit Shqipëri-Kosovë” u inaugurua nga kryeministrat e të dy shteteve. Ky projekt ka për qëllim të shkurtojë procedurat në lidhje me tranzitin e mallrave nga një vend në tjetrin nga disa ditë për vetëm pesë minuta. Nga tani e tutje, të gjitha procedurat doganore për mallrat tranzit, të cilat do të qarkullojnë midis të dyja vendeve do të kryhen vetëm nga zyra përkatëse e vendit të destinacionit<sup>39</sup>. Ky është një hap i rëndësishëm për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të nënshkruara ekonomike dhe një shenjë e qartë se ka një vullnet të fortë nga të dy qeveritë për të zgjeruar më tej bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

Megjithatë, marrëveshjet që synojnë të rrisin volumin e tregtisë duhet të konsiderohen vetëm si pjesë e një strategjie afatgjatë, e cila do të ketë për qëllim krijimin e një zonë të përbashkët ekonomike mes Kosovës dhe Shqipërisë plotësisht në përputhje me standardet e BE-së dhe politikat ekonomike rajonale. Në

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë”.

39. Ministria e Financave-Dogana, “Korridori i Përbashkët Shqipëri-Kosovë”: <http://www.dogana.gov.al/sq/node/94>

këtë kontekst, partneriteti strategjik duhet të shtrihet në një seri dimensionesh politike, juridike shoqërore dhe kulturore, të tilla si: Migrimi dhe tregu i punës, uji, energjia dhe mjedisi, Harmonizimi i Legjislacionit, Siguria e Kufijve, Klima e Investimeve dhe Sektori Financiar, Administrata Publike, arsimi, kultura dhe gjuha.<sup>40</sup>

Objektivi për krijimin e një zone të veçantë ekonomie mes Kosovës dhe Shqipërisë duhet të konsiderohet si një përparësi në aspektin e orientimit ekonomik të dy vendeve. Ekonomitë nga Shqipëria dhe Kosova do të përfitonin nga shfrytëzimi i përbashkët i aseteve më të rëndësishme ekonomike të shtrirë në të dy anët e kufirit. Në këtë drejtim, bujqësia, peshkimi dhe pasuritë minerare mund të luanin një rol vendimtar.

Për arritjen e një rritje të qëndrueshme ekonomike, e cila do shkaktonte krijimin e mundësive të reja të punësimit, ekonomitë e Kosovës dhe Shqipërisë duhet t'i drejtohen më shumë prodhimit. Në 25 vitet e fundit të dyja vendet kanë përjetuar një shkatërrim të aseteve të tyre ekonomike më të rëndësishme dhe këtu industria e rëndë ka pësuar dëmet më të mëdha. Të dy shtetet duhet të promovojnë industri prodhuese<sup>41</sup> përmes politikave të përbashkëta për gjallërimin e prodhimit, duke shfrytëzuar bashkërisht burimet e tyre më të rëndësishme natyrore.

Në këtë kontekst, krijimi i një politike të përbashkët për tregun e energjisë është diçka e domosdoshme. Aktualisht Sistemi Energjetik i Shqipërisë bazohet kryesisht në energjinë e prodhuar nga hidrocentralet në veri të vendit, ndërsa energjia elektrike në Kosovë prodhohet nga termocentralet. Në të dyja vendet, sektori i energjisë elektrike mbështetet ekskluzivisht në shfrytëzimin

40. Dr. Selami Xhepa, "From "shallow" to "deep": Towards a unique economic area Kosovo- Albania.", fq.2.

41. Instituti për Politika Zhvillimore INDEP, "Marredheniet Tregtare Kosove-Shqiperi: Ku jemi dhe si do vazhdojme me tutje", INDPEP Pristina, 2015, pg.33.

e resurseve natyrore. Burimet hidroenergjetike në Shqipëri dhe rezervat e linjtit në Kosovë<sup>42</sup>. Në Shqipëri, prodhimi i energjisë elektrike varet ngushtësisht nga sasia e reshjeve që bien çdo vit në kaskadën e lumit Drin dhe gjatë sezoneve të thata furnizimi me energji elektrike ka qenë shpeshherë i mangët. Në këtë prizëm, sektorët e energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës do të mund të bëhen komplementare për njëri-tjetrin. Termocentralet e Kosovës mund të furnizonin Shqipërinë gjatë verës dhe hidrocentralet shqiptare mund të furnizonin rrjetin elektrik të Kosovës gjatë vjeshtës dhe dimrit.

Të dyja vendet kanë shprehur përkushtimin e tyre për të bashkëpunuar në sektorin e energjisë nëpërmjet një sërë takimesh, deklaratah dhe marrëveshjesh, por deri tani janë ndërmarrë vetëm disa hapa konkretë. Ndërtimi i linjës së interkonjeksionit me tension të lartë (400 kV) midis Shqipërisë dhe Kosovës (e quajtur ndryshe edhe si "Autostrada elektrike"), një projekt jetik për bashkëpunimin në sektorin e energjisë midis të dy vendeve, e cila ishte financuar nga një kredi e Bankës gjermane të zhvillimit "Kfw", u vonua për disa vjet, derisa punimet rifilluan gjatë vitit 2014<sup>43</sup>. Më tej, ka pasur shumë diskutime në lidhje me investime të përbashkëta Shqipëri-Kosovë për termocentralin e ri "Kosova e Re", i cili është planifikuar të ndërtohet në vitet në vijim. Megjithatë, nivelet e larta të ndotjes dhe kostot e larta të investimit e bëjnë këtë projekt shumë të vështirë të realizohet në të ardhmen e afërt.

42. Instituti "GAP", Bashkimi bën Energjinë: Analizë e tregut të përbashkët energjetik: [http://www.institutigap.org/documents/27075\\_Energjia.pdf](http://www.institutigap.org/documents/27075_Energjia.pdf), fq.12

43. Reporter.al, Autostrata e vonuar energjetike Shqipëri-Kosovë shton shpejtësinë: <http://www.reporter.al/autostrata-e-vonuar-energjetike-shqiperi-kosove-shton-shpejtesine/>

### 3.1 Bashkëpunimi Tregtar dhe Problematikat

Marrëdhëniet tregtare midis dy vendeve janë një faktor kyç në intensifikimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Kosovës. Të dyja vendet janë nënshkruese të CEFTA-s (Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore), e cila synon lehtësimin dhe zgjerimin e tregtisë dhe bashkëpunimin ekonomik mes shteteve anëtare të saj, përkatësisht: Shqipëria, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Serbia, Bosnje Hercegovina dhe Mali i Zi. Organizata i detyron të gjithë anëtarët e saj të kenë marrëveshje të tregtisë së lirë me të gjitha vendet anëtare të CEFTA-s dhe deri më tani Shqipëria dhe Kosova kanë ndërtuar marrëdhëniet e tyre tregtare në kuadër të një tregu rajonal të tregtisë së lirë të zhvilluar edhe sipas kritereve të kësaj organizate.

Për shkak të arsyeve historike dhe gjeografike, Shqipëria dhe Kosova kanë ndjekur orientime të ndryshme tregtare. Kosova ka lidhje më të ngushta tregtare me vendet e ish- Jugosllavisë dhe Evropës Qendrore. Nga ana tjetër Shqipëria, për shkak të kontekstit të saj gjeografik, ka lidhje intensive tregtare me Greqinë dhe Italinë.

Në vitin 2014 eksportet e Shqipërisë në Kosovë arritën shumën e 18.774.000.000 lekëve ose 134.100.000 euro, duke e bërë Kosovën partnerin kryesor të eksporteve në rajon. Importet nga Kosova gjatë vitit 2014 kanë rezultuar me 5,976,000,000 lekë ose 42.685.714 euro, ndryshe 1% të totalit të importeve shqiptare<sup>44</sup>. Kosova është partneri i dytë (renditur pas Italisë) i eksporteve të Shqipërisë, ku destinohen 7,3% të eksporteve shqiptare<sup>45</sup>.

Gjithashtu, eksportet nga Kosova për në Shqipëri kanë arritur 43,7

44. Albanian Institute of Statistics (INSTAT), <http://www.instat.gov.al/al/themes/tregtia-e-jashtme.aspx>

45. Idem

milione euro gjatë vitit 2013 duke e bërë Shqipërinë partnerin më të rëndësishëm të eksporteve kosovare në rajon<sup>46</sup>, me përkatësisht 14,9% të eksporteve totale. Megjithatë, sa i përket importeve, Shqipëria mbetet shumë prapa Serbisë, e cila vijon të jetë partneri i importit më i rëndësishëm rajonal i Kosovës me importe që arritën vlerën e 285 milionë eurove në vitin 2013 në kontrast të plotë me importet e Shqipërisë që arritën vlerën e 110 milionë euro gjatë po të njëjtit vit<sup>47</sup>.

Për sa më sipër, shihet qartë se Shqipëria dhe Kosova kanë krijuar lidhje të forta tregtare, duke u bërë kështu partnerë të rëndësishëm eksporti në kontekstin e marrëdhënieve tregtare në rajon. Megjithatë, ekonomitë e tyre mbeten thellësisht të orientuara drejt importit me partnerë tregtarë krejtësisht të ndryshëm. Partneri kryesor në importet e Shqipërisë është Italia (164 milionë euro në 2014), e ndjekur nga Greqia (52 milionë euro sipas 2014)<sup>48</sup>, ndërsa në rastin e Kosovës është Serbia (285 milionë euro në vitin 2011)<sup>49</sup> dhe Gjermania (253 milionë euro në 2013).

Eksportet më të rëndësishme të Shqipërisë drejt Kosovës janë: minerale, lëndë djegëse (më së shumti naftë bruto), energji elektrike dhe mbi të gjitha materiale të ndërtimit dhe metale<sup>50</sup>. Nga ana tjetër, eksportet më të rëndësishme të Kosovës drejt Shqipërisë janë: minerale të papërpunuara, produkte bujqësore dhe ushqimore si

46. Agjencia Kosovare e Statistikave, Tregtia e Jashtme, <https://ask.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/tabelat>

47. Open.data.al, Eksportet dhe Importet sipas shteteve 2005-2013 <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/1142/Deficiti-Tregtar-Republika-e-Kosoves-dhe-Shqiperia-Eksportet-dhe-Importet-sipas-shteteve-2005-2013>

48. Albanian Institute of Statistics (INSTAT), <http://www.instat.gov.al/al/themes/tregtia-e-jashtme.aspx>

49. Kosovo Agency of Statistics, Foreign Commerce, <https://ask.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/tabelat>

50. Albanian Institute of Statistics (INSTAT), foreign trade, <http://www.instat.gov.al/al/themes/tregtia-e-jashtme.aspx>

miell gruri, patate dhe pije<sup>51</sup>.

Volumi i tregtisë midis dy vendeve arriti në rreth 160 milionë euro në vitin 2013, që është shumë i ulët nëse e krahasojmë atë me volumin e tregtisë midis Kosovës dhe Serbisë që arriti në 300 milionë euro gjatë të njëjtit vit<sup>52</sup>. Kjo nënkupton qartë se të dy ekonomitë janë të pazhvilluara me aftësi të ulëta prodhuese dhe shumë të varura nga importet nga vendet e tjera. Tregtia mes Shqipërisë dhe Kosovës ende nuk ka përmbushur potencialin e saj të plotë dhe ka ende shumë çështje që duhet të zgjidhen nga të dyja vendet në mënyrë që bashkëpunimin tregtar të rritet më tej. Për më tepër, është llogaritur se vëllimi i tregtisë midis dy vendeve potencialisht mund të arrijë shumën prej 500 milionë euro<sup>53</sup>.

Marrëdhëniet tregtare janë penguar nga një sërë problemesh që vazhdojnë të minojnë marrëdhëniet ekonomike midis dy vendeve. Faktori më i rëndësishëm, i cili ka kontribuar në masë të madhe në mosmarrëveshjet tregtare janë barrierat jo-tarifore të tregtisë, të tilla si: standarde të ndryshme rregulluese për produkte të caktuara, procedura të gjata doganore, standarde të ndryshme ligjore apo dokumente të ndryshme tregtare si certifikata e origjinës, certifikata e vërtetësisë edhe standarde të ndryshme mbi sigurinë e ushqimit. Siç parashikohet nga marrëveshja për bashkëpunim në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë, të dyja vendet duhet të krijojnë grupe pune të

51. Opendata.al, Niveli i Importit dhe Eksportit të Vendeve të Evropës Juglindore - <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/en/id/276/Niveli-i-Importit-dhe-Eksportit-te-Vendeve-te-Evropes-Juglindore>

52. Open.data.al, Eksportet dhe Importet sipas shteteve, 2005-2013, <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/1142/Deficiti-Tregtar-Republika-e-Kosoves-dhe-Shqiperia-Eksportet-dhe-Importet-sipas-shteteve-2005-2013>

<http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/1142/Deficiti-Tregtar-Republika-e-Kosoves-dhe-Shqiperia-Eksportet-dhe-Importet-sipas-shteteve-2005-2013>

53. Arben Ahmetaj, Minister i Zhvillimit ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Konferenca: “Shqipëria dhe Kosova në kërkim të një të ardhmeje të përbashkët”, AIIS, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë 28.04.2015.

përbashkëta në eliminimin gradual të barrierave jo-tarifore<sup>54</sup>. Deri më tani ky proces ka qenë i ngadaltë dhe jo plotësisht efikas.

Këtu është një përmbledhje e shkurtër e mosmarrëveshjeve tregtare më të rëndësishme mes Kosovës dhe Shqipërisë gjatë viteve të fundit:

- Eksporti i patates nga Kosova në Shqipëri është penguar në shumë raste gjatë periudhës 2009-2012 për shkak të detyrimeve doganore të larta të vëna për këtë produkt nga autoritetet shqiptare<sup>55</sup>. Shoqata e kultivuesve të patates së Kosovës ka akuzuar palën shqiptare për mos respektimin të CEFTA-s dhe Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë midis dy vendeve, duke vendosur tarifa shumë të larta doganore.

- Gjatë vitit 2012, autoritetet kosovare imponuan taksa të larta për eksportet e çimentos shqiptare (35% e vlerës) në Kosovë, me qëllim mbrojtjen e industrisë vendase të çimentos. Supozohet se kjo ishte një përgjigje ndaj masave të mëparshme të Shqipërisë në lidhje me eksportet e patates kosovare<sup>56</sup>. Ka edhe spekulime për ndërhyrje të prodhuesve vendorë të çimentos tek ministria e tregtisë dhe ekonomisë së Kosovës. Autoritetet shqiptare u detyruan të protestojnë tek homologët e tyre në Kosovë dhe taksa më pas u hoq.

- Është raportuar se nga 2010 e në vazhdim produktet farmaceutike të një kompanie farmaceutike kosovare (“Trepharm”) kanë qenë të bllokuar nga autoritetet shqiptare në kufirin midis dy vendeve, për arsye se produktet nga Kosova nuk përputheshin me standardet farmaceutike shqiptare. Oda Ekonomike e Kosovës pretendon se autoritetet shqiptare nuk kanë vepruar në përputhje me kriteret e CEFTA-s për tregti të lirë dhe nuk ka pasur arsye objektive për

54. Dr. Selami Xhepa, Tryezë e rumbullakët: “Sfidat në marrëdhëniet ekonomike midis Kosovës dhe Shqipërisë”, AIIS, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë, 29.10.2014.

55. Kosova Sot, Shqipëria bllokoi patatet kosovare, <http://www.kosova-sot.info/ekonomi/shqiperia-blokon-patatet-kosovare>

56. KohaNet, Kosova bllokoi cimenton e Shqiperise: <http://koha.net/?id=8&arkiva=1&l=103130>



ndalimin e produkteve farmaceutike të Kosovës, për arsye se produktet e “Trepfarm” ishin në përputhje të plotë me standardet përkatëse të BE-së. Në gusht 2014 ministrat kosovarë dhe shqiptarë të shëndetësisë arritën një marrëveshje për të zgjidhur çështjen<sup>57</sup>. Megjithatë, produktet farmaceutike nga Kosova vijnë të bllokohen dhe çështja ka vazhduar të gjenerojë debate të ashpra<sup>58</sup>.

- Në shkurt 2013 Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës, tërhoqi nga tregu për arsye sigurie një sasi të konsiderueshme të qumështit të importuar nga Shqipëria. Qumështi u cilësua të përmbante sasi të larta të Aflatoksinës, një substancë toksike që në sasi të larta mund të rrezikojnë seriozisht shëndetin e njeriut<sup>59</sup>.

- Në mars të vitit 2013 (si një kundërmasë ndaj si më lart) Autoriteti Shqiptar Kombëtar i Ushqimit (AKU) konfiskoi në kufirin me Kosovën më shumë se 74 ton miell gruri, për shkak të faktit se dërgesa e miellit nuk u shoqërua me certifikatën përkatëse që indikonte nivelin e aflatoksinës. Mielli nga Kosova u konfiskua për një herë të dytë në tetor 2014 në kufirin midis dy vendeve, për shkak se këtë herë ai nuk përmbante shumën e kërkuar të proteinave (12,5%)<sup>60</sup>, siç është përcaktuar nga një urdhër i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë.

Të gjitha këto mosmarrëveshje tregojnë se marrëdhëniet tregtare

57. Gazeta Dita, Zgjidhet ngjeri i tregtimit të ilaceve mes Kosoves dhe Shqiperise: <http://www.gazetadita.al/zgjidhet-ngjeri-i-tregtimit-te-ilaceve-mes-kosoves-dhe-shqiperise/>

58. Gazeta Blic, Edi Rama nuk e mban fjalën: vazhdon bllokimi i barnave nga Kosova në Shqipëri!: <http://gazetablic.com/rama-nuk-mbane-fjalen-shqiperia-bllokon-4-vjet-barnat-kosovare/>

59. Gazeta Shekulli, Qumësht me Aflatoksin nga Shqipëria, Kosova e heq nga tregu: <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=17360>

60. Instituti GAP Prishtine, “Harmonizimi i Standardeve të Sigurisë dhe Cilësisë së Produkteve ushqimore në mes Kosovës dhe Shqipërisë”: [http://www.institutigap.org/documents/11395\\_TregtiaMiellit.pdf](http://www.institutigap.org/documents/11395_TregtiaMiellit.pdf), pg.4

mes dy vendeve nuk janë aq të lehta sa mendohet. Zyrtarët në të dy anët e kufirit pretendojnë se pengesat në tregti kanë ndodhur për shkak të procedurave të shumta burokratike dhe të standardeve të ndryshme të zbatuara në lidhje me tarifën doganore dhe sigurinë e ushqimit. Edhe pse kjo është deri diku e vërtetë, përvoja tregon se interesat e kompanive private aktive në degë të ndryshme të ekonomisë së Shqipërisë ose Kosovës gjithashtu luajnë një rol të madh në prapaskenë. Në shumë raste, kompanitë me monopole të mëdha në ushqim, bujqësi apo sektorin e industrisë e ndërtimit, nuk janë të interesuar në marrëdhënie të lira dhe të ndershme tregtare, pasi këto mund të kërcënonin ndikimin e tyre individual ekonomik në Shqipëri apo Kosovë. Në këtë kontekst, zyrtarët në të dy vendet janë bërë shpesh palë me biznese të ndryshme për të mbrojtur interesat private të caktuara duke dëmtuar seriozisht lidhjet tregtare midis dy vendeve.



#### 4. Kultura, Media dhe Arsimi

Kultura dhe gjuha janë faktorët më të rëndësishëm që sjellin Kosovën dhe Shqipërinë më afër njëra tjetrës. Bashkëpunimi në fushën e kulturës midis dy vendeve është akoma në fazën fillestare. Sektori privat, veçanërisht media kanë qenë në këtë fushë shumë më e suksesshme se aktorët shtetërorë. Mediat shqiptare si Digitalb, Supersport, Klan etj <sup>61</sup>, kanë krijuar tashmë lidhjet e konsoliduara me homologët e tyre në Kosovë, duke krijuar premisat e krijimit të një “Albanosfere” kulturore në Ballkan. Sporti është gjithashtu një shembull tjetër, ku të dy vendet kanë marrëdhënie të shkëlqyera. Sot ekipi kombëtar i futbollit të Shqipërisë ka në radhët e tij disa lojtarë me origjinë nga Kosova dhe e njëjta vlen edhe për ekipin kombëtar të basketbollit në Shqipëri. Në disa raste, artistët nga Kosova kanë përfaqësuar Shqipërinë, siç ishte rasti gjatë Eurovizionit që u zhvillua në Baku, Azerbajxhan më 2012. Për më tepër, artistët kanë arritur të organizojnë aktivitete kulturore, të tilla si koncerte, ekspozita, festivale filmi etj, në të dy vendet me nismën e tyre individuale ose të sponsorizuar nga aktorë privatë, pa mbështetjen e shteteve përkatëse. Nga ana tjetër, Marrëveshja për Partneritet Strategjik midis Shqipërisë dhe Kosovës, nënshkruar më 11.01. 2014 vendos në shtyllën e saj të katërt mbi kulturën, arsimin dhe shkencën, drejtimet kryesore për bashkëpunim në këtë fushë, përkatësisht:

- Hartimi i planeve të veprimit dhe strategjive të zhvillimit të përbashkët për arsimin para-universitar në Shqipëri.
- Koordinimi i politikave arsimore të përbashkëta, në përputhje

61. Lutfi Dervishi, Tryezë e rrumbullakët: “Sfidat në marrëdhëniet kulturore, në art dhe në media midis Kosovës dhe Shqipërisë” AIIS, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë 14.11 2014.

me standardet evropiane.

- Hartimi i një platforme me qëllim promovim e iniciativave të përbashkëta të bashkëpunimit në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.
- Koordinimi i politikave në fushën e sportit, në përputhje me standardet evropiane, përfshirë organizimin e përbashkët të aktiviteteve të ndryshme sportive.
- Forcimi i bashkëpunimit mes bibliotekave kombëtare dhe arkivave të të dyja vendeve. <sup>62</sup>

Menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Partneritetit Strategjik, ministritë e Kulturës të dy vendeve zhvilluan takime të ndryshme, të cilat kanë përfunduar në një protokoll bashkëpunimi të nënshkruar në shkurt të vitit 2014.<sup>63</sup> Në bazë të këtij protokollit, të dyja palët janë të angazhuara në hartimin e një axhende të përbashkët kulturore. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, gjatë vitit 2014 janë organizuar nga të dyja vendet disa aktivitete kulturore dhe më pas është hartuar një kalendar i ri aktiviteteve kulturore për vitin 2015. Ministritë e Kulturës të të dy vendeve kanë shprehur gatishmërinë e tyre për një platformë të përbashkët për trashëgiminë kulturore dhe harmonizimin e legjislationit në fushën e kulturës dhe përafrimin e duhur me politikat kulturore të BE-së për eliminimin e barrierave tregtare që pengojnë qarkullimin e lirë të artit, artistëve dhe kulturës midis të dy anëve të kufirit. Në këtë kuadër, të dy qeveritë nënshkruan një marrëveshje për heqjen e tatimit mbi vlerën e shtuar për të gjitha librat, gazetatat, revistat që

62. Shqiptarja.com, Deklarata per Bashkepunimin strategjik Shqiperi-Kosove: <http://www.scribd.com/doc/199103574/Deklarata-per-bashkepunim-dhe-partneritet-strategjik-Shqiperi-Kosove>.

63. Mnistria e Kultures, Kosova dhe Shqiperia me Kalendar te Perbashket Kulturor: <http://www.kultura.gov.al/al/newsroom/deklarata-per-shtyp/kosova-dhe-shqiperia-me-kalendar-te-perbashket-kulturor&page=2>

qarkullojnë në mes të dy vendeve<sup>64</sup>.

Për më tepër, institucionet kulturore nga Shqipëria dhe Kosova kanë nënshkruar një seri marrëveshjesh bashkëpunimi që kanë intensifikuar më tej ndërveprimin kulturor midis dy shteteve. Më poshtë, një listë të shkurtër të disa nga marrëveshjet më të rëndësishme në këtë fushë.

- Marrëveshja e binjakëzimit mes muzeve Kombëtare të Kosovës dhe Shqipërisë. Të dy muzetë kombëtare janë të angazhuar për të ndërmarrë projekte të përbashkëta për tema të ndryshme që lidhen me kulturën kombëtare shqiptare<sup>65</sup>.

- Marrëveshja për themelimin e portalit Albanologjik Shqipëri-Kosovë, të nënshkruar nga drejtori i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në Tiranë më 5 mars, 2011. Kjo marrëveshje ka për qëllim koordinimin e të dy institucioneve për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit mbi artikuj, libra dhe publikime të ndryshme në lidhje me studimet albanologjike.<sup>66</sup>

- Marrëveshja ndërmjet Teatrit të Operës dhe Baletit të Shqipërisë dhe të Kosovës për një kalendar të përbashkët të aktiviteteve, të nënshkruar në Mars 2014.<sup>67</sup>

64. Ministria e Financave, Marrëveshje me Kosovën për heqjen e TVSH-së për librat, revistat, etj

<http://www.financa.gov.al/al/njoftime/fjalime/marreveshje-me-kosoven-per-heqjen-e-tvsh-se-per-librat-revistat-etj&page=1>

65. Koha.net, Binjakëzohen muzetë historikë të Kosovës e Shqipërisë, <http://koha.net/?id=4&l=28798>

66. Biblioteka Kombëtare e Kosovës, Portali Albanologjik Shqipëri – Kosovë, <http://www.biblioteka-ks.org/Arkivi.php>

67. Ora News, TOB i Shqipërisë dhe Kosovës axhendë të përbashkët për aktivitete kulturore, <http://www.oranews.tv/vendi/tob-i-shqiperise-dhe-kosoves-axhende-te-operbashket-per-aktivitetet-kulturore/>

Për sa më sipër, vlen të theksohet se të gjitha këto marrëveshje bashkëpunimi janë shumë të përgjithshme dhe i referohen shumë pak mënyrës sesi ato do të zbatohen. Ministritë përkatëse të kulturës dhe institucionet shtetërore që merren me kulturën duhet të përpunojnë programe më të hollësishme të bashkëpunimit, me qëllim avancimin e mëtejshëm të këtyre marrëdhënieve në të ardhmen. Organizimi i kalendarëve të përbashkët kulturorë është një hap i rëndësishëm përpara, por bashkëpunimi nuk duhet të jetë i kufizuar vetëm në një seri aktivitete kulturore që ndodhin në të dyja vendet. Sfidë më e rëndësishme e bashkëpunimit kulturor ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë është shkalla e ulët e komunikimit dhe ndërveprimit kulturor në hapësirën kulturore midis dy vendeve. Pra, shqiptarët kanë shumë pak informacion për letërsinë në Kosovë, shkrimtarët e saj më të njohur, filmat dhe aktorët e saj më të shquar. E njëjta gjë vlen, edhe pse në një shkallë më të vogël për njohuritë e kosovarëve mbi kulturën e Shqipërisë. Për më tepër, marrëveshjet kulturore kanë rezultuar të jenë në masë të madhe simbolike në natyrë, pa ndikim të vërtetë në forcimin e bashkëpunimit kulturor. Për shembull, marrëveshja për heqjen reciproke të TVSH-së për librat, gazetatat dhe revistat nuk e rritën qarkullimin e lirë të librave mes dy vendeve dhe në ditët e sotme këto artikuj janë ende duke u taksuar si në Shqipëri ashtu dhe Kosovë, pasi dispozitat e nevojshme nënligjore për zbatimin e marrëveshjes ende nuk janë miratuar.<sup>68</sup>

Në lidhje me mediat, marrëdhëniet janë zhvilluar kryesisht nga sektori privat dhe bashkëpunimi midis institucioneve shtetërore është ende në fazën fillestare. Në janar 2014 është nënshkruar një protokoll bashkëpunimi ndërmjet televizioneve publike të të dyja vendeve. Të dyja palët u angazhuan për shkëmbimin e ndërsjelltë

68. Ben Andoni, Roundtable: “Challenges in the Relations on culture, arts and media between Kosovo and Albania”, AIIS, Friedrich Ebert Stiftung, Tirana 14.11 2014.

të programeve televizive, trajnime të përbashkëta dhe mbështetjes teknike<sup>69</sup>. Në mars 2015 Autoriteti i Medias Audiovizuale së Shqipërisë (AMA) nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Komisionin e Pavarur të Mediave të Kosovës për promovimin e bashkëpunimit të ndërsjelltë në çështjet që kanë të bëjnë me rregullimin audiovizual të mediave<sup>70</sup>.

Këto janë hapa shumë të kufizuar në një fushë, e cila ka shumë potencial për të kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të marrëdhënieve mes të dy vendeve. Media ka mundësinë për të informuar njerëzit si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë mbi zhvillimet më të rëndësishme politike, ekonomike dhe kulturore në të dyja vendet, por kjo ka ndodhur në një masë të kufizuar. Në shumicën e stacioneve televizive të Kosovës dhe Shqipërisë, qofshin ato publike apo private, seksionet e lajmeve që vijnë nga ana tjetër e kufirit transmetohen vetëm në kontekstin rajonal. Përveç kësaj, platformat e mediave elektronike mbeten të ndara me një ndërveprim shumë të kufizuar. Për më tepër, për sa i përket medias së shkruar, veçanërisht gazetatat dhe revistat e Shqipërisë apo Kosovës shumë rrallë qarkullojnë në anën tjetër të kufirit. Nuk ka asnjë gazetë të vetme të përditshme në gjuhën shqipe, e cila shpërndahet rregullisht në të dy vendet. Ashtu si në rastin e kulturës, kjo është një shenjë e qartë se komunikimi mes dy vendeve në fushën e mediave është i pamjaftueshëm dhe se përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të përmirësuar këtë situatë. Për këtë arsye paraqitet nevoja e krijimit të një forumi të përhershëm të medias me pjesëmarrjen e aktorëve më në zë të mediave dhe përfaqësuesve të institucioneve përkatëse shtetërore, me qëllim përcaktimin e një strategjie dhe plani të përbashkët të veprimit për krijimin e një partneriteti të ri mediatik Shqipëri-Kosovë.

69. RTK, Kosovo Radio-Television, <http://www.rtklive.com/?id=2&r=12054>

70. Top-Channel, Shqipëri-Kosovë, marrëveshje për mediat audiovizive, <http://www.top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=294477>

#### 4.1. Arsimi

Në çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me arsimin, hapësira më e rëndësishme e bashkëpunimit është hartimi i kurrikulave të përbashkëta shkollore dhe standardizimi i teksteve shkollore.. Marrëveshja për Partneritetin Strategjik midis Shqipërisë dhe Kosovës përcakton se të dy vendet janë të angazhuar për koordinimin e politikave të përbashkëta arsimore, në përputhje me standardet evropiane<sup>71</sup>. Në qershor 2014, ministrinë e arsimit të të dyja vendeve nënshkruan një marrëveshje për “Bashkëpunimin për Unifikimin e Kurrikulës së Sistemit Arsimor Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës”. Marrëveshja parashton heqjen e të gjitha pengesave që parandalojnë studentët nga Shqipëria që të vazhdojnë studimet e tyre në Kosovë dhe anasjelltas. Më tej, sistemet arsimore përkatëse do të ketë një program të unifikuar, i cili do të jetë në përputhje me standardet e BE-së<sup>72</sup>.

Në një konferencë të organizuar në fillim të korrikut të 2014-ës mbi reformat në arsimin para-universitar në Shqipëri, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, znj. Lindita Nikolla, deklaroi se: “Harmonizimi i sistemit të arsimit para-universitar shqiptar me atë të Kosovës dhe sistemet e tjera arsimore evropiane do të zhvillojë më tej kapacitetet e sistemit të arsimit shqiptar për një proces më cilësor të mësimi”<sup>73</sup>.

71. Shqiptarja.com, Deklarata per Bashkepunimin strategjik Shqiperi-Kosove: <http://www.scribd.com/doc/199103574/Deklarata-per-bashkepunim-dhe-partneritet-strategjik-Shqiperi-Kosove>.

72. Ministria e Arsimit, Shqipëri-Kosovë: Nënshkruhet marrëveshja e unifikimit të sistemit arsimor parauniversitar: <http://www.arsimi.gov.al/al/newsroom/lajme/shqiperi-kosove-nenshkruhet-marreveshja-e-unifikimit-te-sistemit-arsimor-parauniversitar>

73. Kosova Press, Reforma e Arsimit, Nikolla: Bashkëpunim Kosovë-Shqipëri: <http://www.kosovapress.com/sq/rajoni/reforma-e-arsimit-nikolla-bashkepunim-kosove-shqiperi-20846/>

Në lidhje me arsimin e lartë, ministritë e arsimit e të dyja vendeve kanë rënë dakord parimisht për standardizimin e kurrikulave, njohjen reciproke e diplomave dhe për lehtësimin e lëvizshmërisë së studentëve mes Universiteteve të Shqipërisë dhe Kosovës<sup>74</sup>.

Në takimin e dytë të përbashkët ndërmjet Qeverive të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, zhvilluar më 23 mars 2015 në Tiranë, u nënshkruan tre marrëveshje:

- Marrëveshja e Bashkëpunimit në fushën e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor
- Marrëveshja për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës dhe kulturës shqiptare në diasporë; (Në bashkëpunim me Ministrinë e Diasporës së Republikës së Kosovës)
- Marrëveshja për koordinimin institucional në avancimin profesional të mësimdhënësve në sektorin e arsimit para-universitar.<sup>75</sup>

Arsimi është një fushë kyçe për progresin social dhe ekonomik të të dy vendeve në të ardhmen. Aktualisht, sistemi arsimor në Shqipëri dhe Kosovë vuan nga mungesa e fondeve, tekstet shkollore të papërshtatshme, korrupsioni, degradimi i infrastrukturës dhe mungesa e kualifikimit të stafit pedagogjik. Për më tepër, politikat liberale në drejtim të përhapjes së pakontrolluar të institucioneve arsimore private, kanë shkaktuar përkeqësimin e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet. Duke pasur parasysh problemet e përbashkëta, të dyja vendet mund të krijojnë një platformë të përbashkët për

74. MAPO, Kosovë-Shqipëri, unifikim i arsimit të lartë:

<http://www.mapo.al/2015/03/kosove-shqiperi-unifikim-i-arsimit-te-larte>

75. Ministria e Arsimit dhe Shkences, Shqipëri-Kosovë, tre marrëveshje për arsimin e dy vendeve:

<http://www.arsimi.gov.al/al/newsroom/lajme/shqiperi-kosove-tre-marreveshje-per-arsimin-e-dy-vendeve>

të adresuar sfidat më të rëndësishme, me të cilat përballlet sistemi arsimor në të dy anët e kufirit. Platforma mund të shërbejë si një orientim i dobishëm për përgatitjen e politikave të reja të përbashkëta të cilat do të synonin krijimin e një sistemi arsimor të unifikuar për Shqipërinë dhe Kosovën.

Akademitë e Shkencave në Kosovë dhe Shqipëri kanë luajtur në të kaluarën një rol të rëndësishëm në formimin e identitetit kombëtar dhe në vendosjen e standardeve të qëndrueshme kulturore dhe gjuhësore që vijojnë të jenë të rëndësishëm edhe në të tashmen. Bashkimi i dy akademive në një të vetme<sup>76</sup> mund të japë një shtysë të re për arsimin, shkencën dhe kulturën. Të gjitha fusha të cilat kanë pësuar dëme të konsiderueshme gjatë tre dekadave të fundit. Një Akademi unike e shkencave mund të luajë një rol vendimtar në procesin e standardizimit të teksteve për ciklin para-universitar dhe Arsimin e Lartë. Përveç kësaj, një Akademi e Shkencave e unifikuar mund të jipte një kontribut të çmuar në zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe midis të dy anëve të kufirit.

76. Alma Lama, Roundtable: “Challenges in the Relations on culture, arts and media between Kosovo and Albania”, Tirana 14 November 2014, AIIS, Friedrich Ebert Stiftung.

## 5. Konkluzione

Marrëdhëniet midis Kosovës dhe Shqipërisë mund të përmirësohen më tej në shumë fusha. Marrëveshja për Partneritetin Strategjik midis të dy vendeve përbën një moment të rëndësishëm në konsolidimin e lidhjeve të ndërsjellta ekonomike dhe i vendos marrëdhëniet midis dy vendeve në një kornizë ligjore dhe institucionale të konsoliduar. Ekonomia mbetet forca më e rëndësishme lëvizëse në marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë dhe në këtë drejtim marrëveshjet për lehtësimin e nxitjen e tregtisë, padyshim që do të kenë ndikimin e tyre pozitiv në forcimin e lidhjeve të ndërsjellta ekonomike. Megjithatë, është e nevojshme që të ndërmerren hapa të tjerë në lidhje me zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara. Politikat e përbashkëta për përafrimin e legjislacionit administrativ dhe tregtar, dhe më e rëndësishmja një strategji të re për orientimin drejt zhvillimit të përbashkët të qëndrueshëm për ekonomitë e dy vendeve janë çështje thelbësore që duhet të adresohen në të ardhmen. Një axhendë e përbashkët për rigjallërimin e industrisë prodhuese dhe politika të përbashkëta në lidhje me energjinë dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore, janë të gjitha iniciativa që mund të sjellin përfitime për ekonomitë e të dy vendeve. Për më tepër, takimet e ardhshme të përbashkëta në mes të dy qeverive duhet të ketë një axhendë të detajuar dhe konkrete në të gjitha fushat që prekin marrëdhëniet reciproke dhe ato nuk duhet të përdoren për arsye nacionaliste apo populiste.

Nga ana tjetër, bashkëpunimi në drejtim të Kulturës dhe Arsimit është ende në fazën e saj fillestare dhe ka një potencial të madh që të dy vendet të mund të shfrytëzojnë në këtë drejtim. Përpjekjet e përbashkëta në këto fusha do të krijojnë një ndërveprim më intensiv duke sjellë zhdukjen graduale të të gjitha keqkuptimeve dhe ndarjeve

të trashëguara nga e kaluara. Ky është një aspekt i rëndësishëm, që padyshim do të kishte një ndikim pozitiv në marrëdhëniet e përgjithshme Shqipëri-Kosovë dhe për këtë arsye duhet të merret në konsideratë nga të dyja qeveritë.

E ardhmja e përbashkët e Shqipërisë dhe Kosovës mbetet e lidhur ngushtë me axhendën botërore dhe evropiane. Nëse Kosova do të arrijë sovranitetin të plotë duke fituar anëtarësim të plotë në Kombet e Bashkuara dhe organizatat tjera ndërkombëtare, perspektivat e saj ekonomike do të përmirësohen dhe marrëdhëniet me Shqipërinë do të përjetojnë një zhvillim të ri. Megjithatë, bashkimi midis të dy vendeve do të vazhdojë të mbetet i papranueshëm, pasi kjo do të shërbente si precedent për vendet e tjera në rajon (p.sh. bashkimi e Republika Srpska-s në Bosnjë e Hercegovinë me Serbinë, Maqedoninë Perëndimore me Shqipërinë etj.). Kufijtë nuk ka gjasa që të ndryshojnë, por konsolidimi i mëtejshëm i marrëdhënieve mes dy vendeve ashtu siç tregojnë edhe zhvillimet e kohëve të fundit, do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Mbetet një pyetje e hapur nëse këto marrëdhënie do të rezultojnë në një zonë të unifikuar ekonomike, një bashkim rajonal doganor apo vetëm në intensifikimin e marrëdhënieve ndërshtetërore. Kjo do të varet nga vullneti dhe aftësitë e të dy qeverive për të çuar përpara këto marrëdhënie në të ardhmen. Këtu, anëtarësimi në BE do të ketë një rëndësi të veçantë. Për shkak të kontekstit të saj të ndryshëm historik dhe politik, Shqipëria ka më shumë gjasa t'i bashkohet BE-së përpara Kosovës. Mirëpo, anëtarësimi i Shqipërisë është i lidhur ngushtë me mënyrën se si ky vend do të përballet me nivelet e larta të korrupsionit, sistemin jo-funksional të drejtësisë dhe mungesën e bashkëpunimit në skenën e saj politike. Në rastin e Kosovës, pavarësia e saj ende nuk është njohur nga pesë vende të BE-së (Spanja, Sllovakia, Qiproja greke dhe Rumania) dhe kjo përbën një pengesë të madhe për ecurinë e procesit të pranimit në BE.

Për më tepër, Serbia ka hapur tashmë negociatat e pranimit me BE-



në dhe është aktualisht në një status më të avancuar në aspektin e integritetit në BE sesa Kosova dhe Shqipëria. Nëse Serbia do të anëtarësohet në BE përpara Kosovës, ka të ngjarë që ajo të imponojë një sërë kushtesh në lidhje me sovranitetin, kufijtë apo ekonominë e kësaj të fundit. Për këtë, Komisioni i BE-së duhet të ndjekë një politikë më aktive për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga të gjitha vendet anëtare të saj. Nëse të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor do të anëtarësoheshin në BE në të njëjtën kohë, perspektiva që ata do të bllokoni procesin e integritetit të njëri-tjetrit nuk do të ishte e mundur.

Aderimi në Bashkimin Europian është për momentin alternativa më e mirë për prosperitetin e Kosovës dhe Shqipërisë dhe në këtë drejtim të dy vendet duhet të përqendrojnë të gjitha përpjekjet e tyre në ndërtimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme, plotësisht në përputhje me objektivat e BE-së të tilla si, solidariteti dhe respekti reciprok, kohezioni ekonomik dhe social, zhvillimi i qëndrueshëm, konkurrenca e lirë dhe heqja e kufijve.

## 5.1 Rekomandime

Me qëllim kontributin e forcimit e mëtejshëm të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kosovës, Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare rekomandon si më poshtë:

- Eliminimin e të gjitha barrierave jo-tarifore që pengojnë marrëdhëniet tregtare mes dy vendeve.
- Zbatimin e të gjitha marrëveshjeve ekonomike të nënshkruara.
- Hapa të mëtejshëm në përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit tregtar, të punës dhe atë bankar midis Kosovës dhe Shqipërisë.

- Strategji afatgjatë për krijimin e një zone të përbashkët ekonomike plotësisht në përputhje me standardet e BE-së dhe politikat ekonomike rajonale.

- Politikat e përbashkëta për promovimin e industrive prodhuese me qëllim ringjalljen e industrisë prodhuese, duke shfrytëzuar bashkërisht burimet më të rëndësishme natyrore të Kosovës dhe Shqipërisë.

- Krijimi i një strategjie të përbashkët afatgjatë të energjisë që do të rezultonte në një treg të përbashkët të energjisë.

- Investime të përbashkëta në projekte të përbashkëta të infrastrukturës. P.sh Linja Hekurudhore që lidh Durrësin me Prishtinën, modernizimi i zyrave doganore përgjatë kufirit të përbashkët, etj.

- Strategji e përbashkët për një turizëm të qëndrueshëm. Ministritë përkatëse të linjës, në bashkëpunim me agjencitë turistike duhet të ofrojnë paketa të përbashkëta turistike Shqipëri-Kosovë, ku do të përfshihen asetet më të rëndësishme turistike të të dy vendeve.

- Krijimi i një forumi të përhershëm mediatik me pjesëmarrjen e aktorëve të mediave dhe përfaqësuesve të institucioneve përkatëse shtetërore me qëllim hartimin e një strategjie dhe një plani të përbashkët të veprimit për një partneritet të ri mediatik Shqipëri-Kosovë.

- Politika të përbashkëta që do të synonin krijimin e një sistemi të unifikuar arsimor për të dy vendet.

- Bashkimi i Akademive të Shkencave të Shqipërisë dhe Kosovës në një Akademi të unifikuar për hartimin e mëtejshëm të politikave të përbashkëta arsimore dhe zhvillimin e përbashkët të gjuhës letrare shqipe.

## REFERENCAT

### Publikime:

Elez Biberaj, “Çështja Kombëtare Shqiptare”, AIIS 2014.

Bernd J. Fischer, “Albania at War: 1939-1945”, Hurst&Co, London, 1999.

Misha Glenny. “The Balkans, Nationalism, War and the Great Powers”, Granta Books 1999.

Tim Judah, “Kosovo: War and Revenge”, Yale Nota Bene-2002

Oliver Jens Schmitt, “Die Albaner: Eine Geschichte zwischen Orient und Okzident”, Verlag C.H Beck.

AIIS, “The state of Albanian Democracy at the eve of 2013 General Elections”, AIIS, Tirana, 2013.

Instituti GAP Prishtine, “Harmonizimi i Standardeve të Sigurisë dhe cilësive të Produkteve ushqimore në mes Kosovës dhe Shqipërisë”: [http://www.institutigap.org/documents/11395\\_Tregtia\\_e\\_Miellit.pdf](http://www.institutigap.org/documents/11395_Tregtia_e_Miellit.pdf)

KIPRED, Kosovar Institute for Policy Research and Development, “Kosova në Kontekst Rajonal: Marrëdhëniet Ekonomike dhe Tregtare”.

Dr. Selami Xhepa, “From “shallow” to “deep”: Towards a unique economic area Kosovo- Albania”.

Instituti “GAP”, Bashkimi ben Energjine: Analizw e tregut tw përbashkët energjetik: [http://www.institutigap.org/documents/27075\\_Energjia.pdf](http://www.institutigap.org/documents/27075_Energjia.pdf)

Instituti për Politika Zhvillimore INDEP, “Marrëdhëniet Tregtare Kosove-Shqipëri: Ku jemi dhe si do vazhdojmë me tutje”, INDPEP Prishtina, 2015.

Dr. Albert Rakipi, “Albania- Kosova, The Centrality of Economics”, Tirana Times, 2010.

### Faqe Interneti:

Banka Botërore: <http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD>

Kosovo Thanks You, [www.kosovothanksyou.com](http://www.kosovothanksyou.com)

Zyra e Be në Kosovë, Bashkëpunimi Teknik dhe Financiar: [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu\\_kosovo/tech\\_financial\\_cooperation/index\\_en.htm](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu_kosovo/tech_financial_cooperation/index_en.htm)

Ministria e Punëve të Jashtme, Asistenca e BE-sw ndaj Shqipwrisw: [http://arkiva.mfa.gov.al/index.php?option=com\\_multicategories&view=article&id=5597:ndihma-finaciare-e-be-se-per-shqiperine&Itemid=65&lang=en](http://arkiva.mfa.gov.al/index.php?option=com_multicategories&view=article&id=5597:ndihma-finaciare-e-be-se-per-shqiperine&Itemid=65&lang=en).

Official Website of the European Union, Summaries of EU legislation, Accession Criteria: [http://europa.eu/legislation\\_summaries/glossary/accession\\_criteria\\_copenhagen\\_en.htm](http://europa.eu/legislation_summaries/glossary/accession_criteria_copenhagen_en.htm)

Bujar Nishani: Bashkimi Shqipëri Kosovë do të ndodhë, Gazeta Tema, 13 Janar 2015: <http://www.gazetatema.net/web/2015/01/13/>

bujar-nishani-bashkimi-shqiperi-kosove-do-te-ndodhe/

Sondazhi Gallup Balkan Survey, kryer më Qershor-Korrik 2010: [http://www.esiweb.org/enlargement/wpcontent/uploads/2009/02/2010\\_Summary\\_of\\_Findings.pdf](http://www.esiweb.org/enlargement/wpcontent/uploads/2009/02/2010_Summary_of_Findings.pdf)

Republika e Kosovës, Komisioni qendror i Zgjedhjeve, Zgjedhjet per Kuvendin e Kosoves 2014: [http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Rezu%20-%20Nivel%20Vendi%20-%20sipas%20subjekteve\\_peufawqvmc.pdf](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Rezu%20-%20Nivel%20Vendi%20-%20sipas%20subjekteve_peufawqvmc.pdf)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet: [http://www2.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-per-kuvend/2013/zgjedhje\\_2013\\_web/lidhja1.pdf](http://www2.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-per-kuvend/2013/zgjedhje_2013_web/lidhja1.pdf)

Delegacion i BE në Organizatën e Kombeve tw Bashkuara, EU facilitated dialogue between Kosovo and Serbia: Agreement on Regional Cooperation and IBM technical protocol, [http://eu-un.europa.eu/articles/en/article\\_11884\\_en.htm](http://eu-un.europa.eu/articles/en/article_11884_en.htm).

Telegrafi.com, “Berisha, lobim per njohjen e Kosoves”: <http://www.telegrafi.com/lajme/berisha-lobim-per-njohjen-e-kosoves-78-5759.html>

Gazeta Tema, Rama ne Rumani kërkon njohjen e Kosovës: <http://www.gazetatema.net/web/2015/02/27/rame-ne-rumani-kerkon-njohjen-e-kosoves/>

Kosova Online, Shqipëria lobim të fuqishëm për njohjen e Kosovës: <http://kosovaonline.info/?page=1,3,20505>

Kosova Press, “OIC adopts resolution on Kosovo”: <http://www.kosovapress.com/en/politics/oic-adopts-resolution-on-kosovo-7307/>

Ministria e Punëve te Jashtme, Misioni, Prioritetet: <http://www>.

[punetejashtme.gov.al/al/misioni/perpresite/prioritetet](http://punetejashtme.gov.al/al/misioni/perpresite/prioritetet)

Ministria e Puneve të Jashtme, “Albania and kosovo inaugurate first joint consulate in Milan”: <http://www.punetejashtme.gov.al/en/press-office/news/albania-and-kosovo-inaugurate-first-joint-consulate-in-milan>

Gazeta Shqip, Ministria e Integritimit Evropian, Klajda Gjoshë vizitë zyrtare në Kosovë:

<http://gazeta-shqip.com/lajme/2014/03/25/ministria-e-integritimit-evropian-klajda-gjoshë-vizite-zyrtare-ne-kosove/>

Ministria e Punëve të Jashtme, Albania in the Region: <http://www.punetejashtme.gov.al/en/mission/albania-in-the-region>

BBC News, Serbia-Albania row over Kosovo mars historic Rama visit, <http://www.bbc.com/news/world-europe-29985048>

Gazeta Panorama, “Mbledhja e dy qeverive, Rama: Te hiqen vizat për Kosovën, turp për Europën”: <http://www.panorama.com.al/mbledhja-e-perbashket-e-qeverive-shqiperi-kosove-neser-ne-1100-ne-pallatin-e-kongreseve-ja-axhenda/>

Shqiptarja.com, Deklarata për Bashkëpunimin strategjik Shqipëri-Kosovë: <http://www.scribd.com/doc/199103574/Deklarata-per-bashkepunim-dhe-partneritet-strategjik-Shqiperi-Kosove>

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), tregtia e jashtme: <http://www.instat.gov.al/al/themes/tregtia-e-jashtme.aspx>

Agjencia e Statistikave të Kosovës, Tregtia e Jashtme: <https://ask.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/tabelat>

Open.data.al, Eksportet dhe Importet sipas shteteve 2005-2013:

<http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/1142/Deficiti-Tregtar-Republika-e-Kosoves-dhe-Shqiperia-Eksportet-dhe-Importet-sipas-shteteve-2005-2013>

Kosova Sot, Shqipëria bllokoi patatet Kosovare: <http://www.kosova-sot.info/ekonomi/shqiperia-bllokoi-patatet-kosovare>

KohaNet, Kosova bllokoi çimenton e Shqipërisë: <http://kohanet/?id=8&arkiva=1&l=103130>

Gazeta Dita, Zgjidhet ngerçi i tregtimit të ilaçeve mes Kosovës dhe Shqipërisë: <http://www.gazetadita.al/zgjidhet-ngerci-i-tregtimit-te-ilaceve-mes-kosoves-dhe-shqiperise/>

Gazeta Blic, Edi Rama nuk e mban fjalën: vazhdon bllokimi i barnave nga Kosova në Shqipëri!: <http://gazetablic.com/rama-nuk-mbane-fjalen-shqiperia-bllokoi-4-vjet-barnat-kosovare/>

Gazeta Shekulli, Qumësht me Aflatoksinë nga Shqipëria, Kosova e heq nga tregu: <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=17360>

Për miratimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë: <http://www.ligjet.org/>,

Ministria e Financave-Dogana, “Korridori i Përbashkët Shqipëri-Kosovë”: <http://www.dogana.gov.al/sq/node/94>

Reporter.al, Autostrata e vonuar energjetike Shqipëri-Kosovë shton shpejtësinë: <http://www.reporter.al/autostrata-e-vonuar-energjetike-shqiperi-kosove-shton-shpejtesine/>

Ministria e Kulturës, Kosova dhe Shqipëria me Kalendar të Përbashkët Kulturor: <http://www.kultura.gov.al/al/newsroom/>

deklarata-per-shtyp/kosova-dhe-shqiperia-me-kalendar-te-perbashket-kulturor&page=2

Ministria e Financave, Marrëveshje me Kosovën për heqjen e TVSH-së për librat, revistat, etj: <http://www.financa.gov.al/al/njoftime/fjalime/marreveshje-me-kosoven-per-heqjen-e-tvsh-se-per-librat-revistat-etj&page=1>

Koha.net, Binjakëzohen muzetë historikë të Kosovës e Shqipërisë: <http://koha.net/?id=4&l=28798>

Biblioteka Kombëtare e Kosovës, Portali Albanologjik Shqipëri – Kosovë: <http://www.biblioteka-ks.org/Arkivi.php>

Ora News, TOB i Shqipërisë dhe Kosovës axhendë të përbashkët për aktivitetet kulturore: <http://www.oranews.tv/vendi/tob-i-shqiperise-dhe-kosoves-axhende-te-operbashket-per-aktivitetet-kulturore/>

Info Media Kosova: <http://www.imalbania.com/kosova/>

Top-Channel, Shqipëri-Kosovë, marrëveshje për mediat audiovizive: <http://www.top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=294477>

Ministria e Arsimit, Shqipëri-Kosovë, Nënshkruhet marrëveshja e unifikimit të sistemit arsimor parauniversitar: <http://www.arsimi.gov.al/al/newsroom/lajme/shqiperi-kosove-nenshkruset-marreveshja-e-unifikimit-te-sistemit-arsimor-parauniversitar>

Kosova Press, Reforma e Arsimit, Nikolla: Bashkëpunim Kosovë-Shqipëri:

<http://www.kosovapress.com/sq/rajoni/reforma-e-arsimit-nikolla-bashkepunitim-kosove-shqiperi-20846/>

MAPO, Kosovë-Shqipëri, unifikim i arsimit të lartë:

<http://www.mapo.al/2015/03/kosove-shqiperi-unifikim-i-arsimit-te-larte>

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Shqipëri-Kosovë, tre marrëveshje për arsimin e dy vendeve: <http://www.arsimi.gov.al/al/newsroom/lajme/shqiperi-kosove-tre-marreveshje-per-arsimin-e-dy-vendeve>

### **Konferenca dhe Tryeza të Rrumbullakëta:**

Tryezë e rrumbullakët: “Sfidat në marrëdhëniet ekonomike midis Kosovës dhe Shqipërisë, AIIS, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë, 29.10.2014.

Tryezë e rrumbullakët: “Sfidat në marrëdhëniet kulturore, në art dhe në media midis Kosovës dhe Shqipërisë” AIIS, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë 14.11 2014.

Konferenca: “Shqipëria dhe Kosova në kërkim të një të ardhmeje të përbashkët”, AIIS, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë 28.04.2015.